

RAPORT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E PËRPUNIMIT TE PROFILEVE METALIKE



“LTS KOSOVO” L.L.C

Zona Kadastrale: Konjuh

Komuna: Lipjan

Parcelat Kadastrale: P-71409036-00164-27

**OBJEKT INDUSTRIAL - PËRPUNIMI
I PROFILEVE METALIKE**

Prishtinë

Nëntor, 20

Titulli i projektit: Përpunimi i profileve metalike Etazhiteti: P+0 dhe P+1	
Aplikuesi i projektit	Emri i kompanisë: “LTS KOSOVA” L.L.C me nr.u. 810810839 Ekrem Qerreti me ID: 1019986400 – drejtor Adresa: Rr. “Lagjia Marigona Residence” pn. Preoc, Graçanicë Kontakti: +383 49 124 508
Lokacioni	Rruga: “Hasan Prishtina” Zona Kadastrale: Konjuh Komuna: Lipjan Parcelat Kadastrale: P-71409036-00164-27 Koordinatat: 7510982.725, 4713040.392 Sipërfaqja: 2500.00 m2
Hartues i raporti për VNM	Dr.Sc. Astrit Shala Nr. i licencës: 32/19/24 Email: astrit-shala@hotmail.com Tel: +383 44 800 098 Adresa: Prishtinë

Investitori: LTS KOSOVO” L.L.C

Hartuesi: Dr.Sc. Astrit Shala

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

Contents

1.	Hyrje.....	6
2.	QËLLIMI I STUDIMIT.....	8
2.1.	Përshkrimi i alternativave të arsyeshme.....	9
3.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	11
4.	METODOLOGJIA E PUNËS	13
4.1.	Zona në studim	13
4.2.	Metodologjia e hartimit të VNM-së.....	13
4.3.	Mbledhja e të Dhënave	15
4.4.	Analizat studimore.....	15
4.5.	Ekosistemet Natyrore	16
4.6.	Sistemi i Mbrojtjes së Natyrës	16
5.	PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT	17
5.1.	Pozita gjeografike.....	17
5.2.	Kushtet klimatike	19
5.3.	Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore	20
5.4.	Pedologjia dhe gjeologjia	23
5.5.	Popullsia	25
5.6.	Bujqësia	26
5.7.	Resurset ujore.....	28
5.8.	Shfrytëzimi i Tokës.....	32
5.9.	Faktorët me ndikim në degradimin dhe ndotjen e tokës.....	35
5.10.	Erozioni	35
5.11.	Menaxhimi i Mbeturinave	36
5.12.	Biodiversiteti	38
5.13.	Aspektet kryesore të gjendjes aktuale mjedisore	39
5.14.	Shëndeti	39
5.15.	Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin	40
5.16.	Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen.....	40
5.17.	Zonimi i territorit të komunës.....	41
5.18.	Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale.....	41
5.19.	Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit	41
5.20.	Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik	42
6.	PËRSHKRIMI I OBJEKTIT	43
6.2.	Destinimi i objekteve.....	44
6.3.	Arkitektura dhe Lidhjet Funksionale të Objektivit.....	45
6.4.	Procesi i Ndërtimit të objektit.....	47
7.	PËRSHKRIMI I PROCESIN TEKNOLOGJIK	53

7.2.	Pajisjet e Prodhimit te Procesit Teknologjik	53
7.3.	Produktet.....	57
7.4.	Lënda e pare për te gjitha produktet e lartcekura.....	60
7.5.	Mbeturinat qe gjenerohen nga ky proces	60
8.	LOKACIONI I OBJEKTIT	62
9.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	63
9.2.	Ndotja e ajrit.....	63
9.3.	Ndotja e tokës	63
9.4.	Ndotja e ujit	64
9.5.	Ndikimet në florë dhe faune	64
9.6.	Mbeturinat	64
9.7.	Zhurma.....	66
10.	MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	68
10.2.	Masat e marra dhe mobilizimi / Para-ndërtimi.....	68
10.3.	Masat e marra gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit.....	69
10.4.	Masat për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.....	70
10.5.	Identifikimi dhe përcaktimi i masave zbutëse dhe menaxhuese	70
10.6.	Masat e marruara në Florë	71
10.7.	Masat e marruara në Faunë.....	71
10.8.	Masat për mbrojtjen tokës Tokë	72
10.9.	Masat e mbrojtjes së ujit	72
10.10.	Masat e mbrojtjes ajër	73
10.11.	Masat për Eficiencen e Energjisë	73
10.12.	Plani Aksional në Raste të Aksidentit.....	75
10.13.	Masat për Rehabilitimin të Sipërfaqës Gjelbëruese pas Përfundimit të Ndërtimit.....	76
11.	MENAXHIMI DHE MONITORIMI I MJEDISIT	83
11.1.	Kontraktori	83
11.2.	Inxhinieri i Mjedisit	83
11.3.	Qeveria e Kosovës / Ministria përkatëse / Klienti	84
11.4.	Autoritetet përkatëse të mjedisit	84
11.5.	Monitorimi i mjedisit	84
12.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	86
13.	Referencat.....	89

Lista e Tabelave:

Tabela 1. Zonat dhe monumentet e Mbrojtura në komunën e Lipjanit.	20
Tabela 2. Lista e Vlera të trashëgimisë kulturore sipas listës së përkohshme.	22
Tabela 3. SPopullsia në komunën e Lipjanit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2011... ..	26
Tabela 4. Shfrytëzimi i Tokës në Komunën e Lipjanit.	33
Tabela 5. Deponimi i mbeturinave në vitin 2021.	37
Tabela 6. Lista e pajisjeve të procesit teknologjik.	53
Tabela 7. Emri i produktit.	57
Tabela 8. Më poshtë edhe tabela e cila tregon Masat për mbrojtjen e mjedisit:	77

Lista e Figurave:

Figura 1. Planimetria e përgjithshme e Objektit Industrial - Prodhimi dhe Përpunimi I profileve metalike.	13
Figura 2. Pozita Gjeografike e Komunës së Lipjanit.....	17
Figura 3. Përbërja Gjeologjike e komunës së Lipjanit.....	24
Figura 4. Boniteti I Tokave në komunën e Lipjanit.....	27
Figura 5. Përshtatshmëria e tokës bujqësore në komunën e Lipjanit.....	28
Figura 6. Harta Fiziko Gjeografike e komunës së Lipjanit.....	29
Figura 7. Harta Zonale e Shfrytëzimit të tokës në komunën e Lipjanit.....	33
Figura 8. Klasifikimi i Erozionit.....	36
Figura 9. Fotografi të gjendjes nga terreni.....	44
Figura 10. Pzicioni gjeografik i lokacionit.....	45
Figura 11. Planimetria e objektit.....	46
Figura 12. Ndarja e objektit.....	46
Figura 13. Foto prerjet e objektit A-A dhe B-B.....	47
Figura 14. Pajisja Automation System.....	54
Figura 15. Pajisja De-Coiler.....	55
Figura 16. Pajisja Roller holder.....	55
Figura 17. 2x Vegël për Prese-Shtance.....	56
Figura 18. Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Distancerave për CD Distancerë-Straight.....	56
Figura 19. Tool- Cross Streight conneting piece.....	56
Figura 20. Punching Unit Aluminium Corner.....	57
Figura 21. Pamje e produkteve që do të prodhohen.....	58
Figura 22. Produktet finale të llojeve të ndryshme të profileve.....	59
Figura 23. Produktet finale.....	59
Figura 24. Lllamarine e zinkuar për prodhimin e Profileve.....	60
Figura 25. Mbeturinat që dalin nga ky proces teknologjik.....	61
Figura 26. Lokacioni I kompleksit (Informacion nga Harta Zonale Komunale).....	62
Figura 27. Madhësia, Specifikat teknike, dimensionet e kontejnerëve.....	65
Figura 28. Lokacioni i kontejnerëve.....	66
Figura 29. Shpjegimi i Shkallës së Zhurmës në Decibel sipas direktivave Evropiane.....	67
Figura 30. Skema në mes dallimeve në poçe.....	74
Figura 31. Etiketimi energjetik sipas BE-së.....	74
Figura 32. Shtresat Pedologjike të sipërfaqes së Tokës.....	77

1. Hyrje

Në kuadër të aktiviteteve për marrjen e lejës ndërtimore është edhe leja mjedisore për ndërtimin e Objekti Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike me etazhitet P+0 dhe Administratë P+1 në rrugën “Hasan Prishtina” në Konjuh komuna Lipjan. investitori “LTS KOSOVO” L.L.C me nr.u.i 810810839 ka bërë përgatitjen e dokumentacionit e nevojshme për hartimin e raportit për ndikim në mjedis për marrjen e pëlqimit mjedisor. Raporti është një dokument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për këtë Objekt. Në bazë të kushteve ndërtimore të lëshuara nga DPUMM – Lipjan me Nr. 8-351/01-56966 të dt. 18.11.2024 është përgatitur ky raport. Me këtë raport duhet të identifikohen dhe analizohen ndikimet që mund të vijnë nga aktiviteti i këtij objekti. Në këtë raport duhet analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e këtij objekti si dhe karakteristikave e potencialeve përkatëse në njërin anë si dhe karakteristikat inxhiniero - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit nga ana tjetër. Nga kjo vjen nevoja që me anë të raportit të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin Objekti Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike dhe mjedisi. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të raportit për vlersimin e ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të identifikimit, të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t’u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Ky raport është përpunuar për ndikimin mjedisor që mund të ketë ndërtimi i këtij objekti dhe gjatë aktiviteti me qëllim të plotësimit të kushteve për marrjen e lejës ndërtimore.

Raporti për lejen mjedisore komunale dhe vlersimet e ndikimit në mjedis po ashtu i referohet ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese në infrastrukturën ligjore në Kosovë. Sipas legjislacionit kosovar (Ligji i vlerësimit të Ndikimit në Mjedis NR. 08/L-181) ku projekti për ndërtimin e Objektit Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike, si çështje i takon ministrisë dhe për këtë shtrohet nevoja vlerim të ndikimit në mjedis.

Ndonëse aktivitetet e projekti në mjedis nuk priten të gjenerojnë efekte të mëdha dhe të pa kthyeshme negative, megjithatë ato në vetvete mund të mbartin efekte mjedisore të cilat duhet të vihen në konsideratë. Vlenë të theksohet që ndërtimi i këtij Objekti, do të ketë ndikim të theksuar në zhvillimin ekonomik të Lipjanit, pasi që është objekt industrial dhe do të zbus papunsinë e zonës si dhe produktet do të shiten dhe eksportohen, të cilat do të kenë ndikim pozitiv në ekonomi.

Përmes këtij raport janë marrë për bazë karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e këtij projekti, si dhe karakteristikat e potencialeve natyrore përkatëse, e në bazë të tyre është bërë identifikimi, si dhe janë analizuar ndikimet e mundshme mjedisore, të cilat mund të rrjedhin gjatë punimit dhe finalizimit të projektit nga veprimtaritë inxhinierike e teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit.

Përmes këtij raportit do të prezantohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten si gjatë punimit – ndërtimit, ashtu edhe gjatë operimit të Objekti Industrial- Për Përpunimin e profileve metalike në relacionin e objektit me mjedisit, andaj ky raport përgatitet me qëllim të identifikimit të ndikimeve potenciale në mjedis, si dhe zbatimin e preventivave të cilat do të jenë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Edhe pse aktivitetet e Objektit Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike nuk priten të gjenerojnë efekte të mëdha dhe të pa kthyeshme negative në mjedis, megjithatë ato në vetvete mund të bartin efekte mjedisore të cilat duhet të merren në konsiderate.

Raporti përshkruan:

- Gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit;
- Kushtet mjedisore ekzistuese;
- Përshkrimi teknik i projektit dhe punimet të cilat do të kryhen;
- Ndikimet e mundshme të projektit në mjedis;
- Identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve dhe ndërmarrja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij biznesi në mjedis janë komponentët kryesore të këtij raporti.
- Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes takimeve dhe bisedave.
- Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale për projekte të ngjashme, janë realizuar vizita në lokacionin e projektit dhe janë bërë fotografi për hartimin e këtij raporti. Territori apo zona në studim nuk është i përfshirë në ndonjë zonë të mbrojtur, monument natyrore, park natyral, rezervat apo park kombëtar.

2. QËLLIMI I STUDIMIT

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për Objektin Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Duhet të bëhen shumë kompromise për të arritur ekuilibrin optimal midis ndërtimit, funksionimit dhe mjedisit. Ky raport thekson disa nga elementet dhe parametrat teknikë që merren parasysh gjatë projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të Objektit Industrial – Për Përpunimin e profileve metalike. Kombinimi i tyre dhe llogaritjet teknike bëjnë të mundur optimizmin e sistemit dhe performancën e tij maksimale.

Pavarësisht hapjes së tregjeve dhe integritetit rajonal që pritet të sigurojnë efekte lehtësuese në drejtim të problemit të furnizimit, është e nevojshme të merren masa sa më shpejt të jetë e mundur për të zhvilluar kapacitetet e duhura gjeneruese, duke marrë parasysh detyrimet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, ndryshimin klimaterik, dhe përmbushjen e kriterëve minimale.

Rëndësia dhe objektivi i këtij biznesi është në atë se zhvillimi i kapaciteteve të tilla ka ndikime të shumta në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të zonës dhe vendit në përgjithësi.

Ndryshimi i infrastrukturës në procesin e vlerësimit të përdorimit hapësinor shihet më së miri në elementet vijuese:

- Mundësia për ripërdorimin e burimeve natyrore;
- Ndikimi në zhvillimin e kapaciteteve të biznesit dhe banimit;
- Ndikimi në zhvillimet urbane, zhvillimin e vendbanimeve dhe cilësinë e mjedisit;
- Ndikon dhe nxit zhvillimin e zonës së biznesit duke stabilizuar tregu për nevojat e konsumatorëve;
- Ndikimi i drejtpërdrejtë në ndalimin e migrimit të banorëve nga zona.

Objektivi i projektit - është avancimi infrastrukturor që synon të përmirësojë kushtet e jetesës së komunitetit, i cili do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin, arsimin, kujdesin shëndetësor, bujqësinë dhe aspektet e përgjithshme të jetës socio-ekonomike.

Qëllimi objektiv i këtij zhvillimi

- Të vlerësojë dhe rekomandojë rregullimin e mjedisit, së pari në lidhje me elementët parësore, siç janë ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmës, uji dhe cilësia e ajrit.

Për të shpëtuar ose rehabilituar mjedisin natyror nevojiten ndërhyrje të reja pozitive në projektin e zbatimit ose punime të veçanta brenda projektit ose paralelisht me të, të cilat sigurojnë një vazhdim të qëndrueshëm të mjedisit biologjik, duke përfshirë florën dhe faunën përreth zonës.

Pos tjerash nevojiten edhe informata shtesë siç janë:

➤ **Informatat themelore mbi:**

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion;
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit;
- Klima dhe të dhënat meteorologjike;
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion;
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

➤ **Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:**

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit;
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti;
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës;
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

➤ **Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis,** duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

2.1. Përshkrimi i alternativave të arsyeshme

Duke u bazuar në faktorë të ndryshëm si:

- Pozita e mirë gjeografike;
- Përshtatshmëria e terrenit (ekspozicioni, pjerrësia, kategoria e tokës);
- Se kjo hapësirë është zonë me rendimente jo të madhe në agrikulturë dhe rrjedhimisht janë një potencial mjaftë i mirë për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive të tilla;

- Distanca me objektet e banimit e mjaftueshme etj.

Duke u bazuar në faktorët e lartë cekur, kuptojmë se lokacioni në fjalë është mjaftë i favorshëm për projektet e kësaj natyre dhe rrjedhimisht këto zona janë zgjedhur për ndërtimin e fabrikave të kësaj natyre. Kjo alternative që është përzgjedhur për arsye se është zonë shumë e përshtatshme për zhvillimin e projekteve të tilla dhe nuk do të ketë efekte në lokalitetin ku zhvillohet. Lokacioni ka qasje të mirë në rrugë.

3. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Para se të fillohet me studimin e një zonë apo operimin e një biznesi i cili i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, është me rëndësi të shqyrtohen ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në karakteristikat e impiantit me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt që është planifikuar të ndërtohet është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së janë si me poshtë:

- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)
- LIGJI I PLANIFIKIMIT NR. 04 / L-174
- LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025
- LIGJI NR. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VSNM)
- LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA
- LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE
- LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES
- LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA
- LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM
- LIGJI NR. 04/L-175 PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT
- LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI
- LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE
- LIGJI NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS, NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-153
- LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE
- LIGJI NR.05/L-081 PËR ENERGJINË
- LIGJI NR.05/L-085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE
- LIGJI NR.05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MZHE) NR. 03/2017 MBI RREGULLAT PËR ZONAT E SIGURISË*

- *RREGULLA – ZRRE/NR.03/2022 PROCEDURA E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E PROJEKTEVE TË ENERGJISË.*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR. 04/2017 PËR KATEGORIZIMIN E NDËRTIMEVE*
- *UHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 02/2022 PËR KUSHTET, MËNYRAT, PARAMETRAT DHE VLERAT KUFIZUESE TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË RRJETIN E KANALIZIMIT PUBLIK DHE NË TRUPIN UJOR*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2021 PËR RREGULLAT DHE NORMAT E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR.16/2015 PËR INFORMIM, PJESËMARRJE TË PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESUARA NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS*

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura (MMPHI).

Përveç dispozitave themelore ligjore rregullatorë të përmendura më lart në lidhje me nevojën për të përgatitur raportin e VNM-së u përdorën edhe rregullore të tjera ligjore, përfshirë ligjet të cilat janë në fuqi. Për shkak se një pjesë e madhe e specifikimeve mjedisore nuk përfshihet në kornizën ligjore të lartpërmendur për të hartuar këtë raport u përdorën rregullore dhe udhëzime ndërkombëtare të përshtatshme në lidhje me mjedisin siç janë Direktiva e VNM (85/337 / EEC).

4. METODOLOGJIA E PUNËS

4.1. Zona në studim

Përcaktimi i zonës së studimit është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme sepse përcakton fushën e procesit të VNM-së. Figura 1 tregon paraqitjen e përgjithshme të “Përpunimi I profileve metalike” duke përfshirë edhe afërsinë e lokacionit.




Figura 1. Planimetria e përgjithshme e Objektit Industrial - Prodhimi dhe Përpunimi I profileve metalike.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale u studiuan në një zonë prej 9-12 km nga qendra e Objektit. Brenda këtij sektori të cilat kanë të bëjnë me natyrën dhe nivelin e mundshëm të ndikimit janë identifikuar dy zona.

Ndikimet e identifikuara brenda secilës zonë kanë karakteristika dhe shtrirje të ndryshme - në përgjithësi, ato përfshijnë ndikime të drejtpërdrejta negative si dëmtim fizik i shkaktuar tokës, burimeve natyrore dhe ndërtimeve ekzistuese, zhurmës, ndotjes së ajrit, etj. Nga ana tjetër, ndikimet në zonat e gjera të studimit kanë karakter më funksional, gjë që lidhet me ndërprerjen e efektit vizual, ndarjen hapësinore të bashkësive, etj.

4.2 Metodologjia e hartimit të VNM-së

Metodologjia e zgjedhur është rezultat i nevojës për të ekuilibruar aspekte të ndryshme të projektit. Qasja aktuale metodologjike bazohet kryesisht në përdorimin e të dhënave në

dispozicion, mostrave të rrezatimit, vizitave në terren dhe ekspertizës së specialistëve të nivelit të lartë.

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për zonën e projektit për “Prodhimi dhe Përpunimi I profileve metalike, i cili ndodhet në Konjuh të Komunës së Lipjanit, në parcelen kadastrale me nr. P-71409036-00164-27 ZK Konjuh, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyrë, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis, kalon në disa faza edhe atë:

➤ **Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:**

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike;
- klima dhe të dhënat meteorologjike;
- karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit;
- kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion;
- bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

➤ **Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:**

- gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit;
- lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti;
- karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës;
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar;
- vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, do të bëhet duke u bazuar në rezultatet/ të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

➤ **Analiza e rrezikimit të:**

- Njeriut;
- vlerave materiale;
- vlerave natyrore.

- Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin e lokacionit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

4.3 Mbledhja e të Dhënave

Vlerësimi i ndikimit në mjedis u përgatit bazuar në disa burime informacioni:

- të dhëna të disponueshme për kushtet mjedisore në Kosovë;
- studime mjedisore të realizuara për projekte të ngjashme;
- specifikimet teknike të projektit, të siguruara nga konsulentët kryesorë të projektit;
- informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren;
- informacioni i mbledhur gjatë konsultimeve me administratën dhe institucionet kombëtare dhe lokale, komunat dhe përfaqësuesit e grupeve të ndryshme socio-profesionale;
- dokumente të tjera specifike teknike të përdorura për vlerësimet mjedisore dhe gjeoteknike renditen në kapitujt përkatës.

4.4 Analizat studimore

Bazuar në analizën e studimit (fushëveprimi), aspektet sociale dhe mjedisore të renditura më poshtë janë identifikuar si potencialisht të ndjeshme në lidhje me zhvillimin e projektit:

- një përzierje e aktiviteteve të ndryshme - përfshirë bujqësinë, infrastrukturën dhe funksionin e banimit - tipike për zonat periferike;
- përdorimi bujqësor i tokës dhe cilësia e mirë e saj;
- jo burime uji nëntokësore, të përdorura për ujë të pijshëm dhe qëllime ujitjeje.

Duke synuar të kemi një hulumtim që do të rezultojë në një Vlerësim të Qëndrueshëm të Ndikimit në Mjedis, janë identifikuar pikat e mëposhtme:

- Identifikimi i kategorive për përdorimin e tokës;
- Identifikimi i ndikimeve dhe konflikteve socio-mjedisore;
- Ndikimi i zhurmës;

- Ndikimet në ndotjen e ajrit;
- Ndikimi në ajër;
- Ndikimi në florën dhe faunën;
- Ndikimi në shëndetin e njeriut;
- Plani i Monitorimit dhe Menaxhimit të Mjedisit;
- Informacioni publik.

4.5. Ekosistemet Natyrore

Ekosistemet natyrore dhe biodiversiteti në Kosovë janë mbresëlënëse. Pozicioni i tij gjeografik, së bashku me faktorët gjeologjikë, pedologjikë dhe hidrologjikë, peizazhin dhe klimën kanë krijuar lloje të ndryshme të habitateve dhe peizazheve, me florë dhe faunë të larmishme, duke përfshirë shumë specie relikte ose endemike. Për shkak të faktorëve ekonomikë dhe historikë, ekosistemet natyrore të fushave janë transformuar ndikuar nga aktivitetet njerëzore dhe kanë humbur shumicën e vlerave të tyre ekologjike. Zona të paprekura dhe të pashkelura ekzistojnë vetëm në zonat malore.

4.6. Sistemi i Mbrojtjes së Natyrës

Sistemi i zonave të mbrojtura natyrore në Kosovë u krijua në vitin 2006 përmes ligjit për ruajtjen e natyrës (Rregullorja 2006/22). Sipas rregullores, zonat e mbrojtura janë "zonat e ruajtjes së natyrës të përcaktuara për të mbrojtur dhe mirëmbajtur biodiversitetin, peizazhet, tiparet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe për të siguruar menaxhim efektiv përmes mjeteve ligjore dhe të tjera.

Në afërsi të lokacionit nuk gjendet ndonjë zonë apo monument I mbrojtur natyror.

5. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT

5.1. Pozita gjeografike

Komuna e Lipjanit ndodhet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, në jug të kryeqytetit të vendit (Prishtina), ku ndahen rrugët kryesore të rajonit. Ajo kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.




Figura 2. Pozita Gjeografike e Komunës së Lipjanit

Sipas të dhënave nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës, regjistrimi I Popullsisë 2011) Në Komunën e Lipjanit jetojnë 57,605 banorë, dhe gjithsejt 62 venbanime ku në zone urbane jetojnë rreth 17% e popullsisë apo 6780 banorë dhe pjesa tjetër 50735 banorë jeton në fshatra zonat rurale në fshatra. Sipërfaqja e Komunës është rreth 338km², me një dendësi të popullsisë rreth 170 b/km², ku dendësia mesatare e popullsisë në shkallë vendi është 205 b/km².

Në pikpamjet geomorfologjike terreni i komunës së Lipjanit në pjesën qendrore është i rrafshët, gjendet në pjesën qendrore të fushës së Kosovës dhe lartësia mbidetare varion 540-550m ku lumi Sitnica i cili kalonë nëpër komunë ndan komunën në dy pjesë në atë lindore dhe

perendimore. mbi 500m është pjesa e cila kalon 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) pjesa më e madhe e vendbanimeve, rrugëve, hekurudhave dhe të tjera janë koncentruar në këtë pjesë. Në Pjesën Lindore të territorit shtrihen vargmalet e Zhegovcit me një lartësi mbidetare 800 deri 1100m ku gjendet edhe pika më e lartë. Kurse në pjesën veri-perendimore mali i Goleshit me një lartësi mbidetare 1019 (pika më e lartë). Në pjesën perendimore shtrihen malet e Drenicës ku në fushëgropën e saj kalon lumi Drenica dhe janë zhvilluar vendbanimet.

Komuna e Lipjanit është një pikë strategjike për trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, pasi aeroporti ndërkombëtar ndodhet në territorin e saj dhe është vetëm 15km nga qendra. Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja, ku ka potencial për t'u kthyer në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin. Në vendbanimin Gadime gjendet Shpella e mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit, por për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva, e cila po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorët.

Komuna e Lipjanit ka 62 vendbanime, ku numri më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës, në pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit. Vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të Komunës.

Gjithashtu, Komuna gjendet në distancë shumë të afërt me qendra të tjera të mëdha të Republikës së Kosovës si: 16km nga Prishtina, 57km nga Mitrovica, 60km nga Prizreni, 96km nga Gjakova, 131km nga Peja, 26km nga Ferizaj 50km nga Gjilani.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të tri rrugëve të rëndësishme Nacionale 25/E 752 Ibrahim Rugova dhe 2/E 65 Hasan Prishtina, si dhe autostradës Arbën Xhaferi dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup.

Me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova është ndarë në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona.

Zona ku bënë pjesë Komuna e Lipjanit: Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) – Zonë administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agro-industriale, turistike. Kjo tërësi paraqet pjesën verilindore të Kosovës të përbërë përpos Lipjanit edhe nga komunat: Prishtina, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Drenasi dhe Shtime në qendër me qytetin e Prishtinës.

Vizioni i Portit të Kosovës: me Vizion të zonës parashihet si një Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet duke përfshirë edhe Lipjanin tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të

planifikuar urban, konkurrent me qytetet tjetra të zonës e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.

Në qendër të zonës së kaltër (trekëndëshi Lipjan-Fushë Kosovë –Prishtinë), parashihet të zhvillohet si TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare.

5.2. Kushtet klimatike

Klima e Komunës së Lipjanit është mjaftë e ngjashme me klimën e Komunës Ferizaj apo Shtimes, si komuna të cilat ndodhen në qendër të territorit të vendit. Ajo ka një klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta. Sipas të dhënave të IHMK (Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës), muajt më të nxehtë të vitit janë Korriku dhe Gushti me një temperaturë mesatare 20.5-20.6 gradë celcius, ndërsa muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare -1.4 gradë celcius. Temperatura mesatare vjetore vlerësohet të jetë 10 gradë celcius, ndërsa në zonat malore temperatura zbret deri në -9 gradë celcius. Maksimumi absolut i temperaturës është arritur në muajin Gusht rreth 37.3 gradë celcius, ndërsa më e ulta gjatë muajit Janar rreth -26 gradë celcius.

Lagështia mesatare vjetore e ajrit vlerësohet të jetë rreth 74.7%. Muaji Gusht është muaji më i thatë me një lagështi rreth 63%, ndërsa Janari është muaji me lagështinë më të madhe 86.1%.

Në këtë regjion vrentësimi mesatar vjetor është 57%, ku gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellta është 57.9, të cilat përbëjnë rreth 15.9% të ditëve të vitit.

Sasirat e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë, ku kemi një sasi mesatare vjetore rreth 673.3mm. Në këtë komunë shpesh herë të reshurat në formën e Breshërit kanë shkaktuar dëme në ekonominë lokale të vendit, ndërsa reshjet e dëborës nuk paraqesin ndonjë problem në komunë, pasi ato janë në sasi të mëdha vetëm në zonat malore.

Frekuencën më të madhe vjetore në këtë rajon e kanë erat verilindore me 226 0/00 ndërsa më pak e kanë erëta lindore (E) me gjithësej 360/00. Shpejtësi mesatare më të madhe e kanë erërat jugperëndimore me 4m/sec.

Komuna Lipjanë shpesh herë ballafaqohet më problemin e vërshimeve si në lokalitetet e banuara ashtu edhe në tokat bujqësore, të cilat gjatë viteve të fundit kanë shkaktuar shumë dëme si:

- Dëmet ekonomike
- Rrezikimi i shëndetit të njeriut
- Ndotje permanente e ambientit

Territori i Komunës së Lipjanit gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore. Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës.

Qyteti i Lipjanit shtrihet në mes të rrafshit të Fushë Kosovës në një lartësi përafërsisht rreth 550 m', majet më të larta në lindje dhe perëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.

5.3. Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore

Në aspektin e trashëgimisë natyrore komuna e lipjanit në nivel nacional ka 4 lloje të zonave të mbrojtura: 1. Rezervati I Blinajës 2. Shpella e Gadimes, si dhe 3. Zonë e veçantë e mbrojtur e Zogjve, 4. Zona e Mbrojtur e Boshtres. Kurse në nivel lokal kuveni I komunës së Lipjanit ka futur në mbrojtje edhe 9 monumente tjera të karakterit hidrologjik, botanik e gjeomorfologjik:

Tabela 1. Zonat dhe monumentet e Mbrojtura në komunën e Lipjanit.

Nr.	Emertimi I zonës / objektit	Vendndodhja	Sipërfaqja në ha	Parcela kadastrale	Vendimi dhe Viti i mbrojtjes	Pershkrim i shkurtër i vlerave	Koordinatat e Lokacionit (KosovaRef01)
1	Shpella e Gadimes	Gadime e Ultë	38.64,95	P-71409028-00700-0 (Parcela Kryesore 90% të sipërfaqes)	Nr.04/57 Dt.13.03.2009	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik	X=7516925 Y=4704612
2	Blinaja	Blinaje	2795	Zona Kadastrale Blinajë (Përfshinë edhe parcela tjera në zonat Kadastrale Krojmir, Leletiq, Ribar I Madh, Shalë, Zllakuqan, Kraishtë, Vërshec)	1955	Rezervat i Gjuetisë me Rëndësi të Veçantë	X=7498795 Y=4708052
3	“Ligatina e Hencit-Radevë”	Henc – Radevë- Vrellë	109.52,35 (Pjesa në	P-71409016-00448-0 P-71409016-	Nga MMPH:	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve. Me vlera dhe karakteristika	X=7503800 Y=4715568

		e Goleshit (Pjesa e territorit të komunës së Lipjanit Vrellë e Goleshit)	komunën e Lipjanit 13.9934 m2)	00447-0 P-71409016-00056-0 P-71409016-00057-0	Nr.08/178 dt.18.03.2014	të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peisazhore.	
4	“Lokaliteti i Boshtrës (Forsythia europea)	Vrelle e Goleshit	33.2	P-71409016-00215-0 P-71409016-00216-0 P-71409016-00218-0 P-71409016-00217-0 P-71409016-00219-0 P-71409016-00213-0 P-71409016-00214-0 P-71409016-00220-1	Nga KK Lipjan: 15Nr.463-60412 dt.14.12.2020	Zonë e mbrojtur Monument i Natyrës.	X=7499633 Y=4714999
5	Trungu i Bungbutës (Quercus pubescens)”	Dobraje e Madhe	0.05	P-71409012-00846-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17295 dt.31.03.2022,	Monument i Natyrës me karakter botanik	X=7503792 Y=4711115
6	Trungu i Bungbutës (Quercus pubescens)”	Baice	0.05	P-71409004-00473-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17438 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik.	X=7492609 Y=4708741
7	“Trungu i Qarrit (Quercus cerris)” Gadime e Epërme	Gadime e Eperme	0.05	P-71409020-01330-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17287 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik	X=7519249 Y= 4705169
8	Trungu i Qarrit (Quercus cerris)”	Resinoc	0.05	P-71409073-01017-2	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17301 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik	X=7494236 Y=4709067
9	“Trungu i rrënjës” (Quecus robur)	Poturoc	0.05	P-71409067-00183-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17433 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik	X=7503648 Y= 4709671
10	“Trungu i Shpardhit (Quercus frainetto)”	Smallushe	0.05	P-71409078-00950-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17219 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik.	X=7516331 Y=4707468
11	Trungu i Shpardhit (Quercus frainetto)”	Bregu I Zi	0.05	P-71409087-00023-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/01-17293 dt.31.03.2022	Monument i Natyrës me karakter botanik	X=7504476 Y=4704120
12	“Burimi i ujit”	Baicë	0.05	P-71409004-00001-0	Nga KK Lipjan: 15Nr.352/03-17249 dt.31.03.2022	Monument i natyrës me karakter hidrologjik	X= 7492354 Y= 4709049
13	“Guri te Kroni”	Kroimir	0.05	P-71409039-01229-0	Nga KK Lipjan:	Monument i natyrës i karakterit	X=7494097 Y=4705249

					15Nr.352/01- 17296 dt.31.03.2022	gjeomorfologjik	
--	--	--	--	--	--	-----------------	--

Tabela 2. Lista e Vlera të trashëgimisë kulturore sipas listës së përkohshme.

KATEGORIA: TRASHËGIMI ARKEOLOGJIK / NËNKATEGORIA: LOKALITET ARKEOLOGJIK/REZERVAT				
NR.	NR.UNIK	EMERTIMI	PERIUDHA	VENDI-KOMUNA
1.	691	Qyteza Parahistorike (Gadime)	Parahistori	Gadime e Eperme Lipjan
2.	3031	Lokaliteti Arkeologjik ‘Ogragje’	Antikitet i Vone, Mesjete	Rubofc, Lipjan
3.	3032	Germadhat e Lokalitetit Arkeologjik Antik ‘Stacio Herculana’	Romake	Gushterice e Larte dhe e ulet, Lipjan
4.	42	Qyteza ne Klecke	Antikitet i Vone	Klecke, Lipjan
5.	684	Qyteza “Kodra e Qytetit”	Parahistori, Mesjete	Bajice, Lipjan
6.	3697	Gjurmët e Qytetit te Janjeves	Antikitet i Vone	Janjeve, Lipjan
7.	3708	Lokalitet arkeologjik i kohës romake ne Torine	Romake	Torine, Lipjan
8.	3712	Lokalitet arkeologjik ne Babush te Muhaxhereve	Romake	Babush te Muhaxhereve
9.	2905	Gërmadhat e kishës se Shen Gjonit ne Sllovi	Mesjete	Sllovije, Lipjan
10.	2906	Gërmadhat e kishës se “Shen Nikoolles”	Mesjete	Sllovije, Lipjan
11.	2907	Germadhat e Manastirit mesjetare Shen Gjergji ne Sllovi	Mesjete	Sllovije, Lipjan
12.	2912	Kishe varrezore e fshatit ne Toplican	Mesjete	Toplican, Lipjan
KATEGORIA: TRASHËGIMI ARKITEKTURORE / NËNKATEGORIA: MONUMENT/ANSAMBËL				
NR.	NR.UNIK	EMERTIMI	PERIUDHA	VENDI-KOMUNA
13.	2903	Kisha e Shpalljes se Virgjëreshës, Lipjan	Shek. XIV	Lipjan
14.	2904	Bunkeri i LNÇ - së - Vrrellë	Shek. XX	Vrellë – Lipjan
15.	2911	Tyrbja e Isak Babës	Shek. XVIII	Teqe - Lipjan
16.	2913	Shkolla fillore në gjuhën Sërbe - 1882	Shek. XIX	Gushtericë e Epërme-Graçanicë
17.	2760	Xhamia në Shalë (Sedllarë)	Shek. XVIII	Shalë (Sedllarë)
18.	36	Shtëpia Muze e At Shtjefën Gjeçovit	Shek. XX	Janjevë
19.	43	Kulla e Pashkë Karadakut - Janjevë		Janjevë – Lipjan

20.	41	Shtëpi me ballkon –Glasnoviq Josipa Maria.		Janjevë - Lipjan
21.	44	Xhamia e Janjevës	Shek. XVII	Janjevë – Lipjan
22.	4293	Bunari i familjes Olluri		Krojmir, Lipjan
23.	76	Xhamia ne fshatin Llugaxhi		Llugagji- Lipjan
24.	4655	Shtëpi banimi, ish-Selia e shtabit te brigades 121- "Komandant Kumanova"		Krojmir, Lipjan
25.	4685	Shkolla shqipe Banullë		Banullë-Lipjan

Sipas PZHK-së është konstatuar se duhet të zhvillohen projekte që mundësojnë mbrojtjen e vlerave të TK-së nga dëmtimet e mëtutjeshme, por edhe të zhvillohen në bazë të potencialit që kanë këto vlera. Parashikimet janë që të gjitha objektet dhe vlerat të futen në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme ose përhershme në nivel komunal, të Kosovës dhe disa edhe ndërkombëtar.

Bazuar në listën e objekteve të përkohshme të MKRS-së, përpos objekteve të luajtshme të cilat nuk janë paraqitur në këtë dokument, në komunën e Lipjanit janë gjithsejtë 25 vlera të trashëgimisë kulturore si trashëgimi arkeologjike dhe trashëgimi arkitekturore.

Bazuar në Ligjin për trashëgimi kulturore, trashëgimia kulturore nën mbrojtjen e përkohshme, ka attribute të njëjta me trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme, andaj me HZK rregullat për zhvillim vlejné për të gjitha vlerat njësoj.

5.4. Pedologjia dhe gjeologjia

Në territorin e komunës së Lipjanit gjenden 22 tipe tokash me një numër të madh nëntipesh. Tipet më të përfaqësuara janë smonicat më tepër se 25.24%. Këto toka janë mjaft të mira, të thella, kryesisht të përbërjes së argjilit, neutrale, të pasura me humus dhe kalium aktiv, por jo mjaft të pasura me fosfor aktiv dhe kanë pjellori mjaft të madhe potenciale. Ndërkohë në komunë ka edhe disa toka të tjera si:

- Smonicat pa karbonate, të cilat dallohen me mundësinë e dobët të lëshimit të ujit e posaçërisht në shtresën punuese, dhe reaksionit të dobët të thertë, prandaj kanë vlerë më të vogël bujqësore se sa smonica karbonate. Këto toka dhe smonicat e lesuara kërkojnë masa përmirësuese si rregullimit të regjimit uJOR-ajror, dhënien e sasive më të mëdha të fosforit në tokë etj.
- Smonicat e erodura dhe smonicat e kafenizuara me pseudoglej, të cilat gjenden në territore më të larta malore, prandaj erozioni i eroduar ka çuar pjesërisht një pjesë të horizontit humusor, duke i bërë këto toka gjysmë të thella deri të cekëta.

- Tokat aluviale përfaqësojnë rreth 22.87% të sipërfaqes, dhe kryesisht këto toka gjenden rreth degëve të lumit “Sitnica”. Këto janë toka me veti të përshtatshme fiziko-ujore dhe me vlerë të lartë bujqësore. Në këto toka organizohet prodhimtari intensive bujqësore.
- Tokat e kafenizuara të cekëta në rrasat shkëmbore-ranore janë të përfshira me rreth 5.67% dhe tokat e kafenizuara të mesme të thella në rrasat shkëmbore-ranore përfshinë 8.54% dhe’. Këto toka dhe tokat e tjera të kafenizuara gjenden në terrenet e larta dhe kryesisht janë toka pyjore nën pyje.
- Tokat livadhore – teltnore dhe tokat livadhore-argjillore janë të përfaqësuara me rreth 3% dhe gjenden kryesisht përreth lumit “Sitnica”.
- Tokat podzole-pseudoglej janë toka, të cilat e kanë vlerën e kufizuar bujqësore për shkak të cilësive (vetive) të këqija ujoro-fizike dhe shtresën punuese e cila nuk e lëshon ujin, dhe ka përmbajtje të madhe argjillore. Në mënyrë që këto toka të shfrytëzohen intensivisht në bujqësi është e nevojshme që të bëhen masat agromelioruese.
- Tokat deluviale përfshinë 5.36% nga territori i përgjithshëm i komunës.




Figura 3. Përbërja Gjeologjike e komunës së Lipjanit.

Në Komunën e Lipjanit ka pothuajse të gjitha lëndet e para minerale, madje në sasi dhe cilësi të lartë. Më të rëndësishme janë lëndet e para minerale energjetike dhe pikërisht linjiti. Lëndet e para minerale të metaleve, rezervat e xehes së Nikelit, pjesërisht Fekurit, Kromit, Kobaltit etj, pastaj kemi rezervat e lëndëve të para jometalore, rezervat e magnezitit, dunitëve, materialeve të ndërtimit gëlqerorëve, rërave kuarcore, rërave dhe zhavorreve.etj.

Mineralet e jometaleve kanë një përhapje të konsiderueshme në komunën e Lipjanit të cilat gjithashtu janë të dislokuara në pjesën lindore dhe përendimore të Lipjanit, në afërsi të vendbanimit Medvec gjendet vendburimi Dunitëve, Rëra kuarcore në vendburimin, Llozishtë’’ në Sllovi, Vendburimi i Magneziti,, Golesh’’- Magurë, Vendburimi i mermereve të dolomitizuara në Babush të Muhaxherve, Vendburimi i shkëmbit gëlqerorë në Shalë, Vendburimi i glëqerorëve të mermerizuar,,Mirena’’- Mirenë,Vendburimi i gëlqerorëve, “Baicë’’-Baicë, Rezerva të konsiderueshme të shkëmbit gëlqerorë në komunën e Lipjanit ndodhen në vendbanimet Krojmir, Baicë në Malet e Blinajës (Lipovicë) të cilat do të kenë një perspektiv në të ardhmen për komunën e Lipjanit.

5.5. Popullsia

Lidhur me popullsinë, burimet njerëzore dhe tregun e punës, janë me rëndësi të veçantë të bëhen analiza socio-ekonomike, meqenëse në të shumtën e rasteve të dhënat ekzistuese statistikore janë të pamjaftueshme, për shkak se nuk ofrojnë informata të sakta sa i përket numrit të banorëve se ku jetojnë, vendit ku jetojnë jashtë Komunës së Lipjanit dhe nuk ofrojnë të dhëna se sa banorë të komunave të tjera punojnë në Komunën e Lipjanit.

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Lipjanit ka gjithsej 57605 banorë. Duke iu referuar territorit dhe numrit të banorëve, Komuna e Lipjanit radhitet si Komuna e tretë në Kosovë për nga madhësia.

Në Komunën e Lipjanit dendësia e popullsisë është mesatarisht rreth 170 banorë për km² . Rreth 17% e popullsisë, banojnë në zonën urbane dhe 83% në zonën rurale. Për nga përkatësia etnike, Shqiptare 54667 banorë, serb 513, turq 128, boshnjak 42, rom 342, ashkali 1812, Egjiptian 4, të tjerë 260, të papërcaktuar 31.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të kryer më 2011, popullsia totale është 57,605.

Tabela 3. SPopullsia në komunën e Lipjanit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2011.

Popullsia në Komunën e Lipjanit	gjithsejt	Etniteti							
		shqiptar	serb	turq	boshnjak	rom	ashkali	egjiptian	Te tjere
Total	57,605	54467	513	128	42	342	1812	4	291

Duke iu referuar hartës Zonale të Komunes së Lipjanit nga fusha e banimit teritori I Komunes është planifikuar në Zona si:

Zonat e banimit: Zona rurale me intenzitet të ulët ku bëjnë pjesë 55 vendbanime: Akllap, Babush i Muhaxherve, Baicë, Banullë, Breg i Zi, Brus, Bujan, Bukovicë, Divlakë, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gadime e Ulët, Gllanicë, Gllavicë, Glllogoc, Grackë e Vjetër, Grackë e Vogël, Gumnasellë, Hallaç i Madh, Hallaç i Vogël, Hanroc, Kleqkë, Kojskë, Konjuh, Kraishtë, Krojmir, Leletiq, Lipovicë, Llugagxhi, Llugë, Marec, Medvec, Mirenë, Okosnicë, Plitkoviq, Poturoc, Qellapek, Qylagë, Resinoc, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Rubofc, Rufc i Ri, Rufc I Vjetër, Smallushë, Shisharkë, Teqe, Tërbufc, Topliqan, Torinë, Varigoc, Vërshec, Vogaçicë, Vrellë, Vrellë e Goleshit, dhe Zllokuqan me gjithsejt 37959 banore (regjistrimi ASK 2011).

- Zona Sipërfaqe rurale me intenzitet të lartë përfshinë 5 qendra të rendit të ulët: Janjevë, Slllovi, Shalë, Gadime dhe Magure.... Gjithsejt 12393 banorë.
- Sipërfaqe suburbane përfshin zonën periferike të qytetit të Lipjanit3350banorë
- Sipërfaqe urbane e përgjithshme- zonën urbane1628banore
- Sipërfaqe urbane qendrore – pjesa qendrore e qytetit 2156 banore.

5.6. Bujqësia

Komuna e Lipjanit karakterizohet si vend bujqësor sepse gjerë më tani bujqësia është degë e rëndësishme e ekonomisë në nivel komunal.

Komuna e Lipjanit ka pozitë mjaft të përshtatshme gjeografike sepse gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme në Kosovës. Komuna e Lipjanit, pjesa dërmuese e teritorit ndodhet në fushëgropën e basenit të Kosovës, e cila karakterizohet me toka të prodhimtarisë së lartë.

Përmes territorit të kësaj Komune rrjedh lumi “Sitnica” përreth dhe përgjatë së cilit shtrihen sipërfaqet më të pëlleshme bujqësore, mbi të cilat mëtej shtrihen gjithashtu sipërfaqe të mëdha të fushave mjaftë të pëlleshme dhe të përshtatshme për prodhimtari bujqësore intensive.

Duke u nisur nga fakti se bujqësia është dega e dytë ekonomike për nga rëndësia, dhe se prodhimi i ushqimit ka rëndësi strategjike për shoqërinë tonë, në planin ekonomik të zhvillimit të komunës për periudhën e ardhshme, zhvillimit të bujqësisë duhet dhënë një nga rëndësit prioritare.




Figura 4. Boniteti I Tokave në komunën e Lipjanit.

Me analizimin e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin më të shpejtuar të prodhimtarisë bujqësore, është konstatuar se një ndër faktorët me rëndësi limituese është toka e pa rregulluar, të cilën e karakterizojnë ngastrat e vogla dhe të shpërndara të ekonomisë në sektorin individual. Kjo gjendje e tokës nuk mundëson aplikimin e masave bashkëkohore agroteknike në masë të duhur dhe përdorimin e makinave dhe stabilimenteve tjera në procesin e prodhimtarisë në formë racionale.




Figura 5. Përshtatshmëria e tokës bujqësore në komunën e Lipjanit.

5.7. Resurset ufore

Në aspektin hidrografik ujrat në komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenjë janë lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeqare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madhë në komunën e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë ndërsa, në anën perendimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sasitë më të mëdha të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin.

Sa i përket sipërfaqeve ujore në komën e Lipjanit lumnj të mëdhenjë janë: lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Degët e Sitnicës janë: Lumi Janjevka, Lumi

i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë dhe Lumi i Vërshevcit. Sipërfaqja ujore përbën 182 ha (1.1%) nga sipërfaqja totale e territorit të komunës së Lipjanit




Figura 6. Harta Fiziko Gjeografike e komunës së Lipjanit.

Përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezona të caktuara, të cilat janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale. Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e bores patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që atij t'i krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë pa pengesa

Në komunën e Lipjanit është me rëndësi të trajtohen ujërat që shkaktojnë përmbytje e që vinë si rezultat: I përrenjve në zonat malore gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe • E dyta në zonën e rrafshët ku për shkak të mungesës së pjerrësisë së terrenit ujit të shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

Aktualisht KUR,,Prishtina” sh.a NjOU – Lipjan, e cila është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën e Lipjanit, e cila ka këto të dhëna mbi përfshirjen e zonës së shërbimit; Ofron shërbime për qytetin e Lipjanit dhe 29 fshatra, me numër të konsumatorëve prej 38383 , koha e shërbimit – ofrimit të ujit të pijshëm është 24 orë, pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme tjera (reduktimet energjisë) në stacionin e pompave dhe tubacionet – rrjetin shpërndarës të ujësjellësit. Burimet e marrjes së ujit janë ujërat nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të sistemit të pompimit thithës, këto puse ndodhen në zonën aluviale të lumit Sitnicë (saktësisht në lokalitetin ish fabrika e letrës dhe te livadhet e Sitnicës). Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon kjo njësi operative i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Metoda e pastrimit, trajtimit – përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorimi.

Si prioritet - Mbrojtja e resurseve ekzistuese të ujrave:

Përmirësimi i mbrojtjes së burimeve ujore në sistemet rurale të ujërave

KRU "Prishtina " sh.a. Njesia Operative e Ujesjellesit ne Lipjan ka afer 12000 konsumatore te cilet furnizohet nga keto burime nentokesore ne akuifer intergranular.

Lokacionet e puseve nentokesore te cilet furnizohen qytetaret e Komunes se Lipjanit;

- Tete (8) puse te ish fabrika e Letres (parcellat jane ne prone private) ekziston vendimi per mbrijten e zonave I II II;
- Shtatë (7) puse te livadhet afer ETC Kurse Njëri nuk është më aktiv dhe ka shumë vite që nuk bëhet furnizimi me të për ujë Parcela është private), për këto puse nuk kemi vendim për mbrojtjen e tyre;
- Gjate (6) puse te arat e Konjuhut (parcelat pjeserisht jane prone e Komunes) është në proces vendimi per zonat mbrojtese I II III;
- Nje (1) pus ne Vrelle (parcela eshte prone e Minjeres se Magnezitit Magure);
- Kater (4) puse Marec (parcelat jane ne prone private);
- Pese (5) puse grumbulluese ne Sllovi (parcellat jane ne prone private);
- Tri (3) puse ne Qylage qe nuk jane te shfrytezueshem (parcela eshte pronë e Komunës);
- Burimet e ujit qe nuk menaxhohen nga KRU Prishtina, Shale, Krojmir, Resinocv

Ndotja e ujërave Rrjedhjen e ujrave të zeza në gjithë territorin e komunës është problem mjaft i madh, ku rreth 35% llogaritet se janë kyçur në rrjetën e kanalizimit ku derdhja e tyre

rrjedh ne lumenj dhe procka" te pa trajtuara, ndërsa rrjetat e kanalizimit të ndërtuara pas luftës në disa fshatra, derdhja e tyre bëhet në ambient te hapur duke ju nënshtruar trajtimit nëpërmes gropave septike. Aktualisht nuk ka informacione të sakta sa I përket shkallës së kyçjes së familjeve private në rrjetin e grumbullimit të ujrave të zeza. Është vlerësuar se 50 deri 70% e popullsisë së qytetit të Lipjanit është i kyçur në sistemin e kanalizimit. Duke pasur parasysh pjesët rurale të komunës thuhet që vetëm një pjesë e vogël e popullsisë është e lidhur në rrjetin e sistemit të kanalizimit. Objektet e banimit që nuk janë të kyçra në sistemin e kanalizimit I derdhen ujrata e zeza në lumenjapo procka të vogla, shfrytzojnë gropat septike ose lejojnë që ujrata e zeza të derdhen në dhe/tokë. Pjesë të rrjetit të kanalizimit janë në gjendje shkatërrimi. Një pjesë e konsiderueshme e kanalizimeve mendohet se rrjedhin të pakontrolluara dhe shkaktojnë ndotjen e dheut dhe ujit tokësorë. Uji I shiut shkarkohet kryesisht në kanalizime. Drenazhe të ndara të ujrave të shiut ekzistojnë pjesërisht vetëm në qendrën e qytetit të Lipjanit. Stacionet e trajtimit të ujit kompatible me standardet e Evropës Perëndimore nuk ekzistojnë ende. Megjithatë planifikohet të ndërtohen qendra për trajtimin e ujit në qytetin e Lipjanit dhe pjesët tjera të komunës. Duhet të konkludohet se sistemi I kanalizimit në Lipjan është qartë në nivel të papranueshëm. Niveli i ulët i grumbullimit të ujrave të zeza, rrjedhjeve në rrjetin e kanalizimit dhe mungesa totale e qendrave për trajtimin e ujrave të zeza çon në kontaminimin organik të lumenjve dhe prockave, dheut dhe ujrave nëntoksore.

Fatkeqësisht ky kontaminim paraqet rrezik në shëndetin njerëzor pasi që furnizimi me ujë në komunë është ekskluzivisht i varur nga ujrata toksore (shiqo kreun „ 1.9.1 Furnizimi me Ujë“). Si arsye e kësaj duhet ti frigohemi ndotjes së florës dhe faunës. Perspektiva: siç u tha më herët (shiqo kreun “1.9.1 Furnizimi me ujë”) shfrytëzimi I ujit do të rritet dukshëm.

E njejta gjë vlen për sasinë e grumbullimit të ujrave të zeza në të ardhmen. Duke u bazuar në këto zhvillime në fushën e grumbullimit të ujrave të zeza, është më se e qartë se rrjeti I kanalizimeve duhet të zgjerohet dhe modernizohet. Për më shumë duhet të ndërtohen qendra të trajtimit të ujrave të zeza për ti përballuar kërkesave të së ardhmes.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimeve duhet të kemi një menaxhim më të përgjithshëm. Element thelbësor në menaxhimin modern të ujrave është grumbullimi ndaras I ujrave të shiut dhe ujrave të zeza. Përderisa ujrata e zeza duhet të grumbullohen dhe të trajtohen në system të mbyllur, ujrata e shiut duhet trajtuar afër vendeve ku kemi qarkë grumbullohen dhe të trajtohen në system të mbyllur, ujrata e shiut duhet trajtuar afër vendeve ku kemi qarkullim natyror të ujit.

Kjo nënkupton mbajtje dhe kullim/filtrim të ujit të shiut në mënyrë që të mos kemi ndonjë vërshim, dhe ndihmon në koston e investimeve për infrastrukturë.

Shkarkimi i ujërave atmosferike bëhet në 3 pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin Sitnicë, ndërsa një pikë kryesore për tërë qytetin e Lipjanit shkarkohet në drejtim të livadheve të Sitnices. Trajtimi i ujërave të ndotura – Gjendja ekzistuese Fusha e trajtimit të ujërave të ndotura është çështja më problematike, pasi që ekzistojnë kostoja e lartë e ndërtimit të impiantëve me standarde evropiane. Në komunën e Lipjanit trajtimi i ujërave të ndotura bëhet vetëm me një trajtim primar përmes gropave septike, dhe pastaj shumica e atyre ujërave dredhen nëpër lumenj, të cilët grumbulohen në lumin Sitnicë. Për shkak të kostonë së madhe për implementimin e impiantëve për trajtimin e ujërave të ndotura, komuna nuk ka mundur të bëjë ende zgjidhje, përjashtimisht vetëm në dy vendbanime ka bërë zgjidhje.

Në fund të procesit të ndërtimit është impianti i trajtimit të ujërave të ndotura për vendbanimet Vrellë dhe Medvec sipas standardeve evropiane. Në funksion të kësaj komune e Lipjanit ka hartuar një strategji për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në nivel komunal dhe mbi këtë strategji është duke i implementuar projektet e sistemit të kanalizimeve. Në bazë të hartës Zonale Komunale në pjesën lindore të teritorit përkatës në Gadime pritet të ndërtohet akumulacioni apo I quajtur liqeni I Gadimë

5.8. Shfrytëzimi i Tokës

Në përgjithësi rreth 60% e popullatës në Komunën e Lipjanit merren me bujqësi, dhe një pjesë e madhe e popullatës jeton në mërgim ku edhe krijon të hyra të mjaftueshme për disa familje. Tokat pjellore shtrihen në pjesën e rrafshit të komunës, rreth lumenjve dhe prrockave dhe kryesisht shfrytëzohen për bujqësi, me një trend të rritjes së shëndërrimit të tokave pjellore në ato ndërtimore dhe sipërfaqe të pa mbjellura (djerrina). Në këtë aspekt mungojnë hulumtime përkatëse për kualitetin dhe shfrytëzimin e tyre.

			vetjak		
1.2	Pylltari	1.2.3	Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	13,350	39.4
2.1	Industri e lëndës së parë	/	/	376.7	1.1
2.3	Industri e prodhimeve të lehta	/	/		
1.3	Miniere dhe Gurore	1.3.3	Miniera dhe gurore tjetër	333	1.0
4.1	Rrjetet të transportit	4.1.1	Infrastruktur e e transportit rrugor	698	2.1
4.1	Rrjetet të transportit	4.1.2	Infrastruktur e e transportit hekurudhor	20.5	0.1
4.1	Rrjetet të transportit	4.1.3	Infrastruktur e e transportit Ajror	412	1.2
3.3	Shërbim i komunitetit	3.3.1	Shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale	81.7	0.2
3.3	Shërbim i komunitetit	3.3.2	Shërbim arsimor	52.1	0.2
3.3	Shërbim i komunitetit -	3.3.3	Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	3.8	0.0
3.3	Shërbim i komunitetit -	3.3.4	Shërbim fetare	57.4	0.2
3.3	Shërbim i komunitetit -	3.3.5	Shërbim tjetër i komunitetit - Varreza	87.8	0.3
3.3	Shërbim i komunitetit -	3.3.5	Shërbim tjetër i komunitetit	2.8	0.0
3.1	Shërbimi tregtar	/	/	538	1.6
3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	/	/	29.8	0.1
6.3	Tokë natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	6.3.1	Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	183.4	0.5
	TOTAL			33,849	100

5.9. Faktorët me ndikim në degradimin dhe ndotjen e tokës

Natyra e Lipjanit është shumë e vlefshme. Ajo ka shumë funksione, është shtëpi për shumë lloje të florës dhe faunës, ofron rekreacion për banorët lokal dhe tërheq turistët që kontribuojnë në ekonominë lokale. Mirëpo, degradimi i tokave bujqësore është si rezultat i ndërtimeve dhe planifikimit jo të mirë, infrastruktura jo adekuate, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga mungesa e trajtimit të ujërave, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane, si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesa e riciklimit etj.

Një ndër çështjet me rëndësi në fushën e mbrojtës të mjedisit është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Degradimi i pyjeve po ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve, të cilat e kanë edhe rolin e mbrojtësit, nga erozioni. Uji i shkaktuar nga të reshurat e mëdha po kalon pa ndonjë pengesë në shtretërit e lumenjve, që si rezultat kemi vërshimet. Rrezik tjetër permanent paraqesin edhe të reshurat, të cilat ndikojnë në rritjen e sasisë dhe nivelit të ujit në lumenj, të cilët të pambrojtur vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokës kualitative bujqësore. Perdorimi i pakontrolluar i pesticideve të ndryshme për trajtimin e barojave të kqija, procesi i degradizimit gjithashtu edhe transformimi i tokave bujqësore në toka ndërtimore etj.

5.10. Erozioni

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmytje (vërshime). Faktorë të tjerë që shkaktojnë vërshime, janë edhe mbeturinat nëpër lumenj, si dhe rrokullisjet e gurëve nga bjeshkët.

Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave dhe kjo si rezultat i mungesës së pan-dave mbrojtëse. Komuna ka bazën e të dhënave për rrjedhat e lumenjve dhe erozioneve dhe i ka vendosë ato në GIS harta që tregojnë zonat ku vërshimet mund të ndodhin. Këto të dhëna do të shërbejnë për mbikqyerje të vazhdueshme të lumenjve dhe për analiza hapësinore për nivelin e ndikimeve nga vërshimet. Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse të nivelit qendror duhet të hartojë planin e veprimeve nga vërshimet dhe masat zbutëse për përgjigje të menjëhershme ndaj rreziqeve nga vërshimet.

Erozioni është njëri nga faktorët mjaftë të rëndësishëm për ta trajtuar nga se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezentë pothuaj në tërë territorin e komunës së Lipjanit në forma dhe madhësi të ndryshme. Përshpejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka luajtur edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por

edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj. Komuna e Lipjanit ka bazën e të dhënave dhe hartat e nevojshme të cilat tregojnë zonat e rrezikuara nga erozioni, si dhe në bazë të Hartës Zonale Komunale se cilat aktivitete ndalohen dhe lejohen në këto zona.

Territori i komunës së Lipjanit karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozion shumë i dobët 30% erozionit të dobët përfshijnë sipërfaqen rreth rreth 30% të territorit. Erozioni i mesëm 27%. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Lipjanit përfshijnë 9 %. Erozioni shumë i fortë 2 %.




Figura 8. Klasifikimi i Erozionit.

5.11. Menaxhimi i Mbeturinave

Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit e bënë KRM “PASTRIMI: NJ.O. LIPJAN. Kjo kompani kryen shërbime në qytetin e Lipjanit dhe fshatrave të Komunes së Lipjanit, përkatësisht në 57 fshatra. Në sistem për menaxhimin e mbeturinave janë përfshirë 8839 ekonomi familjare nga gjithsej 9497 sa janë në Komunën tonë, ku mbulueshmëria e tyre është rreth 90 %. Kjo kompani ofron shërbime edhe për biznese që operojnë në Komunën e Lipjanit.

1895 biznese të ndryshme nga 3076 sa janë të regjistruara apo afër 70%, dhe Institucionet afër 85 % realizohet shërbimi.

Menaxhimi i mbeturinave ne Komunen e Lipjanit është nje nder sfidat me te medha ku si faktor ndikojn pagesat e uleta mekanizmi i vjetersuar numri i vogel i punëtorëve.

- Ridizajnimi i pikave të përgjithshme të vendosjes së kontenjerëve konform numrit të banorve,
- Funksionalizimi dhe menaxhimi i lokacionit për grumbullimin e mbetjeve inerte,
- Vënija nën kontroll e të gjithave mbetjeve shtazore,
- Mungesa e kontenjereve 1.1m në disa pika të nevojshme brenda qytetit
- Nevoja për rritjen e numrit te automjeteve në shërbim të bartjes së mbeturinave.
- Format e reja të mënyres së riciklimit te mbeturinave.

Shkalla e inkasimit ne vitin 2021

Tabela 5.Deponimi i mbeturinave ne vitin 2021.

Amvisëritë	417,927.25
Bizneset	42,050.72
Institucionet	218.76
Sasia e mbeturinave	10053.12 TON.

Ne qytetin e Lipjanit shërbimi zhvillohet 7 ditë në javë nga ora 19 ne mbremje. Në pjeset nderurbane dhe fshatra shërbimi kryhet dere me derë nje her ne javë. Mbulueshmeria me sherim ne Qytet është 80%. Mbulueshmeria ne fshatra është 90%. Numri i punëtorve është 58 qe konsiderohet jo i mjaftueshem duke pase parasysh rritjen e numrit te ekonomive familjare ne sistem.

Mekanizimi: gjithsej 7 kamion te kapacitetit 1.1M, nje kamion te kapacitetit 7, nje Auto fshisë, Kamion te Bores, Eskavator -ngarkues, Autoveture dhe Kamion transportues.

Ngritja të shërbimit, planifikohet detyrimi i lidhjes së kontratave me disa biznese të caktura të cilat kanë shfrytëzuar shërbimin por i jane shmangur obligimeve ndaj ndërmarrjes, Kerkohet një bashkpunim në rritje me institucionet komunale në rritjen e kualitetit të shërbimeve dhe shumë segmente të tjera.

Zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave të bëhet në tër komunën. Mbyllja dhe mbulimi i vendhuhjeve ekzistuese në përputhje me standardet e Evropës Perëndimore. Planifikimi i vendhuhjes së re të mbeturinave duhet të jetë komplementar me krijimin e hapsirave të seleksionimit edhe për (hapsira për trajtimin termal dhe biologjik) të mbeturinave. Zvogëlimi i sasisë së riciklimit të mbeturinave, gjegjësisht të bëhet promovimi i çasjeve

ekonomike. Të bëhet pastrimi i vendhuhdheve ilegale të mbeturinave sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që komuna e Lipjanit të ofrojë një ambient atraktiv për investitorët dhe qytetarët.

Rekomandohet një program i menjëhershëm për mbledhjen e mbeturinave të hudhura ilegalisht.

5.12. Biodiversiteti

Komuna e Lipjanit ka një shtrirje mjaft të madhe gjeografike e cila përfshin zonat mesatarisht të larta dhe zonat e ulëta të terrenit. Në këtë komunë sa i përket fitodiversitetit i lidhur me llojet e bimëve drunore shkon deri te brezi i ahishteve (*Fagus silvatica*) të përziera me bungë (*Quercus petraea*), ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqime mjaft të mdha dhe të begatshme me lloje. Poashut në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve dhe vendbanimeve por edhe barojat e këqia të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdeve. Sa i përket Zoodiversitetit kjo komunë me fshatrat që e tangjentojnë këtë komunë janë të pasura me llojllojshmëri të mjaftueshme shtazore, këtu vlenë të përmendet Rezervati Natyrorë Blinaja.

Prezenca e shumë shtazëve të egra, si dreri, kaprolli, derri i egër, mufloni, macja e egër, lepuri, ujku, dhelpera etj., si dhe shumë shpezë, e bëjnë këtë vend atraktiv. Vetë kushtet natyrore në Blinajë mundësojnë një regjenerim të botës bimore dhe shtazore mjaft të përshtatshëm dhe mundësi për një rezervat gjuetie dhe rekreacion për shumë vizitorë.

Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e komunës së Lipjanit, parashikohet që disa lloje të mbrohen, ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.

Sa i përket zoodiversitetit, sipas të dhënave, dhe analizave të ekipit punues territori i komunës së Lipjanit është i pasur me kafshë të egra, vlenë të veçohet Rezervati Blinaja dhe zona të tjera në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara dhe në këtë drejtim, parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë, dhe bimë si dhe mbrojtja e tyre si specie. Në fushën e biodiversitetit, parashihen projekte të përbashkëta me komunat tjera. Parashihet inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mundë të shfrytëzohet.

Parashikohet një rezervat për ruajtjen e kaprollit (*Capreolus capreolus*), ujkut (*Canis lupus*), dhelprës (*Vulpes vulpes*), arealet e të cilave janë mjaft të rrezikuara.

Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore, në territorin e komunës së Lipjanit. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj.

5.13. Aspektet kryesore të gjendjes aktuale mjedisore

Të dhënat e mëposhtme dhe më lartë i përkasin gjendjes së tanishme mjedisore në komunën e Lipjanit. Qëllimi kryesor i paraqitjes së të dhënave baze është të identifikojë gjendjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të hartës zonale komunale të komunës së Lipjanit në lidhje me investimin e propozuar. Impaktet potenciale të zhvillimit të HZK-se mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e dokumentit nëpërmjet indikatorëve të gjendur-të supozuar sasiore ose cilësore. Esencialisht, gjendja mjedisore e komunës së Lipjanit karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisore, siç kërkohet nga direktiva e VNM-së, të përbashkuara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrës;
- Cilësia e ajrit;
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët klimatik, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peizazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

5.14. Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e publik për VNM, janë ato të cilat lindin si pasoje e bashkëveprimit me receptorët mjedisore (komponente mjedisore të tilla si ajri, uji apo toka) nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para se gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dendësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapësirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa

dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisore të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime më të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Në komunën e Lipjanit, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF.

5.15. Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndërtimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe menaxhimi i mbetjeve.
- Mbrojtja e Vegjetacioneve autoktone;
- Mbrojtja e zonave të llojeve bimore endemike;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit

5.16. Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçorit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani.

Shumëfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërësie pejsazhesh e gjelbërimi

5.17. Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqërore arkitekturat, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Lipjanit me HZK janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

- Zonat e pazhvilluara me ndërtim:

HZK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastruktur tjetër.

- Zonat turistike

HZK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Lipjanit kurse nuk janë të prezantuar në hartën e turizmit.

5.18. Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashme është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me HZK dhe duhet propozuar masat mjedisore. Në hartë nuk është e paraqitur kufiri i zonës industriale.

5.19. Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit

Komunën e Lipjanit sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës zhvillimet nuk i kanë favorizuar pyjet dhe zhvillimin e tyre, sidomos pyjet e zonave të ulëta (Shpardhit me qarr). Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve veihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë e prerjeve ilegale, djegieve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në HZK. Deri tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjashme.

Esenciale çka HZK-ja duhej ofruar është sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për

këmbësorët dhe biçikletat dhe tampon zonave të zhvillimet industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

5.20. Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

HZK duhet të tregoj qartë në hartë vendet ku kemi erozion dhe çfarë shkalle të erozionit nëse kemi erozion shumë të fort ose të fort atëherë të merren rreptësishtë masa për parandalimin e tyre, po ashtu duhet të tregoj për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren kundër vërshimeve.

Pos tjerash duhet të merren parasysh:

- zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit duke e precizuar qartë në hartë (pjesa grafike);
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i Pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbërues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

6. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Investitori “LTS KOSOVO” L.L.C me nr.u.i 810810839 përfaqësuar nga Ekrem Qerreti me ID: 1019986400 – drejtor është duke planifikuar ndërtimin e Objektivit Industrial – Për Prodhimin dhe Përpunimin e profileve metalike. në parcelën kadastrale: P-71409036-00164-27 me sipërfaqe 2500.00 m² e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale 2306/2024 dt. 13.11.2024 e cila është në posedim të Komunës së Lipjanit sipas Aktit Nr.2306/2024 – Kontratë Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës në ZK Konjuh me nr. 010-462/01-55248 për LTS KOSOVO” L.L.C me nr.u.i 810810839.

Objekti ka qasje në rrugën - “Hasan Prishtina” nëpërmjet rrugëve dytëzore të kësaj zone. pikërisht në qendrën pjesën veriore të komunës së Lipjanit. E Gjithë zona është e ndërtuar me objekte industrial, komerciale, depo, afarizëm, përmbajtje tjera të nevojshme, të cilat blloqe kufizohen më rrugët interne të objektit. Profilet e rrugës janë të projektuara në llogari të plotësimit të kërkesave të qarkullimit të lagjës në formë që të I plotësoj kërkesat e banorëve. Sipërfaqja e objektit do të jetë pikërisht sipas kushteve të lëshuara nga DPUMM – Lipjan me nr 8-351/01-56966 të dt.18.11.2024 pra 50 % shfrytëzueshmëria e parcelës Pllakëzimi i sipërfaqës do të bëhet me elemente të gres procelanit që do të reprezentoj nivelin e investitorit dhe kualitetit të tërë kompleksit. Këto sipërfaqe do të pasurohen edhe me gjelbërim dekorativ.

Zona posedon infrastrukturën teknike rrjet të ujësjellsit, kanalizim, elektrik, të PTK-së.

Materialet e përdorura janë bashkëkohore si dhe ruajnë energjinë. Furnizim me ujë të pijes dhe higjienë do të bëhet nga ujësjellsi rajonal KUR “Prishtina”, ku do të vendosen paisje në të gjithë objektet e kompleksit që do të kenë kursim të ujit, duket vendosur gypa të qëndrueshëm dhe duke harmonizuar shtypjene ujit sipas standardeve. Kurse sa I përketë mbeturinave grumbullimi I tyre do të bëhet nga KRM “Pastrimi”.

Ujitja e sipërfaqeve gjelbëruese do të bëhet nga pusi (bunari) I cili do të hapet Brenda parcelës, ku do të vendoset pompa së bashku me sistemin pikë-pikë nëntokësor të ujitjes. Ngrohja e objekteve të kompleksit gjatë sezonës dimërore do të jetë me energji elektrike për kundër vendosjes së objektit në pozitën dhe qëndrim dhe ndriçim si dhe materialet e përdorura do të jenë termoizoluese dhe të shëndetshme.



Figura 9. Fotografi të gjendjes nga terreni.

6.2. Destinimi i objekteve

Lokacion ofron hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e objektit si dhe qasje të lehtë në rrugët vendore dhe ndërkombëtare për transportimin e produkteve tona.

Në këtë parcelë, LTS Kosova SH.P.K., planifikon të ndërtojë një objekt rreth 1200 m² ku do të përfshihen: salla e prodhimit, hapësirat deponuese, hapësirat për ekspozimin e produkteve, si dhe hapësirat për administratë dhe nevoja tjera të punonjësve. Për më shumë informata rreth objektit që planifikojmë të ndërtojmë ju lutem t'i referoheni Planit Ideor të ndërtimit të objektit afarist.

Objektet e kompanisë që do të vendoset procesi teknologjik i prodhimit do të ndërtohen në parcelën që ka një sipërfaqe prej 25 ari në ZK Konjuh të Lipjanit, nr. (P-71409036-00164-27) parcelë e cila është e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve tona prodhuese dhe aktiviteteve të tjera tregtare dhe shërbyese, figura me poshtë është paraqitur lokacioni i objektit.





Figura 10. Pzicioni gjeografik i lokacionit.

6.3. Arkitektura dhe Lidhjet Funktionale të Objektit

Objekti i Depos LTS është projektuar si objekt me etazhitet P+0 në objektin e Depos dhe P+1 në objektin e Administrates. Hyrja në objekt dhe në parcele është e orientuar nga ana veriore. Në pjesën veriore të parcelës kemi parkingjet për personelin dhe vizitorët duke përfshirë edhe hyrjen në administratë për automjete si dhe hyrjen e personelit të kompanisë.

Objekti i administrates ngritet me një sistem skeletor të përbërë nga shtyllat e betonit të armuar me pllaka masive meskati me trarë të lëshuar vetëm në perimetër përderisa fondimi i objektit është paraparë të bëhet me themel shiritor me mur perimetrik,

Kurse objekti I depos është sistem me konstruksion celiku me themele të vecuara. Mbyllja e objektit është paraparë të bëhet me blloqe argjile me gjerësi 25 cm ndërsa ndarjet e brendshme realizohen me blloqe argjile me gjerësi 20 cm dhe gjerësi 12 cm.



Ne figurën me poshtë është paraqitur pozicioni i hapësirës që do të vendoset procesi i prodhimit dhe pjesa e administratës.




Figura 13. Foto prerjet e objektit A-A dhe B-B

6.4. Procesi i Ndërtimit të objektit

Pas marrjes së lejes ndërtimore kompania do të fillojë me procesin e ndërtimit të objektit si pas hapave me poshtë.

Punët Parapregaditore - Përfshijnë punët rreth pastrimit të parcelës nga të gjitha gjësendet dhe objektet që janë pengesë për mbarëvajtjen në mënyrë që të lirohet parcela e paraparë për qendrën e zjarrëfikësve dhe më pas vazhdohet me rrethimin e punishtës, me shenjëzimin informativ si dhe me rregullimin e rrjetit të përkohshëm elektrik, ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe vendosjen e kontejnerit në punishtë. Lokacioni i tillë siç është me pjerrësi të vogël.

Punët e dheut dhe Zhavorit - Në këtë fazë të punëve së pari kemi të bëjmë me largimin e humusit në tërë sipërfaqen ku do të ndërtohet objekti në fjalë, pastaj gjërmimin e dheut për hapjen e gropës ndërtimore për themelin pllakë të objektit deri në kuotën e paraqitur si në pjesën grafike të projektit e më pas edhe hapjen dhe thellimin e kanaleve për muret perimetrike të fondimit. Pas gjërmimit dhe nivelizimit të dheut duhet të bëhet ngjeshja e dheut me cilindër deri në arritjen e kompaktësisë së duhur të pasuar me shtrimin e zhavorit/gurit të thyer me fraksion 60/90 mm në një shtresë kompakte mbi të cilën më pas punohet tamponi nga betoni i varfër me trashësi 5 cm për shtrirjen e themeleve shiritore-pjesa e administrates.

Më pas, vetëm pasi të jenë betonuar muret e themeleve perimetrike bëhet mbushja e hapësirës brenda këtyre themeleve perimetrike me zhavor/gur të thyer me fraksion 60/90 mm dhe kompaktësimin e tij deri në kuotat e paraqitura në pjesën grafike. Paraprakisht duhet të bëhet

ngjitja e termoizolimit Austrotherm XPS 30 përgjatë mureve perimetrike në të katër anët për të pakësuar dhe eliminuar urat termike në konstruksionin e betonit.

Punët e Betonit - Këtu kemi të bëjmë me betonimin e të gjitha elementeve duke filluar me betonimin e themeleve perimetrike shiritore, shtresën e betonit të varfër nën themele shiritore, betonimin e pllakës së dyshemesë së përdhesës, pllakes se katit, betonimin e pllakës së fundit, betonimin e shtyllave të betonit me dimensione të ndryshme, trarëve, shkallëve, strehëve, arkitrajeve mbi dyer e dritare, shtyllat dhe cerklazhet për shtangimin e mureve të atikës si dhe elemente tjera.

Shtresat e betonit mbrojtës mbi zhavor nën themelet shiritore si dhe nën pjesët e pllakave mbi dhe do të punohen nga betoni i varfër i markës c-16/20 me trashësi 5 cm me qëllim të punës më të shpejtë e më të lehtë dhe për krijimin e bazamentit ku elementet e armaturës mund të pozicionohen më lehtë për krijimin e shtresës mbrojtëse pa u përzier me material që shkapërderdhet.

Të gjitha elementet konstruktive të betonarmesë duhet të realizohen nga betoni i markës c-25/30 përderisa disa nga elementet specifike nga betoni i armuar si pllakat e dyshemesë së përdhesës ne objektin e depose dhe muret e themeleve janë paraparë që të realizohen nga betoni me aditive për padepërtueshmërinë e ujit dhe më gjerësisht këto materiale do të elaborohen tek pjesa e punëve të hidroizolimit.

Betoni - Për klasën e kërkuar të betonit në rastet kur përdoret betoni i gatshëm duhet të kërkohet reçeta e përzierjes nga fabrika e betonit si dhe konsistenca e betonit sipas standardeve ISO-4109. Shqyrtimet e betonit duhet të bëhen duke marrë mostrat kubike me dimensione 20x20 cm nga betoni i freskët për çdo parti betonimi. Pas mirëmbajtjes adekuate ato duhet të testohen në laboratorët e autorizuar dhe licencuar. Pas ekzekutimit të punëve të konstruksionet e betonarmesë duhet të bëhet shqyrtimi i betonit me Sklerometër në prani të Organit Mbikqyrës.

Çimentoja Pc 45s - Për çimento nga duhet të kërkohen atestet nga prodhuesi si dhe të verifikohet afati i përdorimit dhe gjatë ndërtimit të verifikohet gjendja e çimentos kur të bëhet hapja e thasëve nëse vërehen shenja të lagështisë ose strukturës së kokërrizuar.

Agregati (Zhavorri) - Para prodhimit të betonit në punishte punëkryesi është i obliguar ti përmbahet reçetës së projektuar dhe për këtë duhet të sigurohet që përbërja granulometrike të jetë e sajuar nga tri apo më shumë fraksione agregati për një përbërje sa më optimale dhe njëherit të sigurohet se i tërë agreegti do të jetë i pastërt nga lëndët organike dhe mbeturinat e dëmshme.

Punët e Armimit - Punët e armaturës përfshijnë armimin e të gjitha elementeve konstruktive nga betoni i armuar. Në këto punë përfshihet prerja, lakimi, lidhja dhe formësimi i elementeve nga armatura të cilat janë specifikuar me paramasën dhe llogaritjen statike. Për këto punë është paraparë përdorimi i armaturave me diametër të ndryshëm të përcaktuara nga llogaria statike. Armatura e përdorur duhet të jetë e pastër nga korrozioni ndërsa për të siguruar mbrojtjen e saj edhe pas vënies në vepër duhet të përdoren elementet e gatshme nga PVC-ja - si distancerat e llojeve të ndryshme për tu siguruar për ekzekutimin e duhur të punëve dhe arritjen e trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.

Para se të vazhdohet me blerjen e armaturës paraprakisht duhet të kërkohen atestet nga prodhuesi dhe duhet të bëhet edhe verifikimi i trashësisë së shufrave respektivisht diametri i tyre dhe sipas nevojës edhe shqyrtimi i mostrave në laboratore adekuate. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080.

Punët e dheut dhe Zhavorit - Në këtë fazë të punëve së pari kemi të bëjmë me largimin e humusit në tërë sipërfaqen ku do të ndërtohet objekti në fjalë, pastaj gjurmimin e dheut për hapjen e gropës ndërtimore për themelin pllakë të objektit deri në kuotën e paraqitur si në pjesën grafike të projektit e më pas edhe hapjen dhe thellimin e kanaleve për muret perimetrike të fondimit. Pas gjurmimit dhe nivelizimit të dheut duhet të bëhet ngjeshja e dheut me cilindër deri në arritjen e kompaktësisë së duhur të pasuar me shtrimin e zhavorit/gurit të thyer me fraksion 60/90 mm në një shtresë kompakte mbi të cilën më pas punohet tamponi nga betoni i varfër me trashësi 5 cm për shtrirjen e themeleve shiritore-pjesa e administrates.

Rruga për qasje në lokacion - Për qasje në lokacionin ku parashihet të ndërtohet Objekti Industrial për përpunimin e profileve metalike dhe për lokacionet rrethore, qasja është përmes (rrugës ekzistuese) e cila është e shtruar me asfalt, dhe si e tillë shërben pa pengesa që në lokacion të jetë qasja e mire dhe funksionale në çdo kohë. Siguri për komunikacion në çdo kohë.

Rrethoja e lokacionit - Rrethoja parashihet të jetë nga rrjeti i telit (metalike) më lartësi 1.6m, me shtylla përforcuese nga çeliku jo korrediv në distanca jo më të mëdha se 1.5m. Rrjeti i telit rrethues është i dendur dhe jo korrediv. Në kuadrin e hyrjes është dhe porta hyrëse me gjerësi 4+4m (8m) me qasje nga skaji më jug-perëndimor i parcelës. Rrethoja si e tillë nuk pengon vizurat ambientale në zonë, pengon vetëm qasjet e personave të pa autorizuar në parcelë, njëherit edhe si siguri fizike e parcelës.

Masat gjatë fazës së para ndërtimit - Para fillimit të ndërtimit duhet të bëhet rrethimi dhe sinjalizimi i vendit të nderimit sipas praktikave dhe legjislacionit në fuqi. Puna përgatitore përfshinë pastrimin e terrenit-lokacionit të ngushte nga mbeturinat dhe gjësendet e dëmtuara.

Vend-ndërtimi duhet të organizohet sipas skemave standarde të organizimit të vend-ndërtimeve në funksion të mjeteve të cilat do të përdoren, dinamikës së punimeve ndërtimore si dhe sigurimit të personelit.

Në rast të krijimit të pluhurit do të merren masa gjatë këtyre punimeve që mos të përdoren mjete të vjetruara apo me defekte të cilat mund të emitojnë vlera të larta të zhurmës, që do të kishin efekte negative në mjedis.

Gjatë organizimit të vend ndërtimit duhet të sigurohet qasje nga rrugët sekondare të automjeteve/mjeteve që do të përdoren në procesin e ndërtimit, përfshirë qasjen për zjarrfikësit, në dy pika: në hyrje dhe në dalje të vend ndërtimit si dhe qasjen drektë në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit konform.

Punimet sipërfaqësore rreth lokacionit - Lokacioni ka rrugë për qasje nga pjesa lindore, zonat tjera rreth lokacionit janë profil natyral pa ndërhyrje në florën ekzistuese. Rruga ekzistuese nga ana lindore është e qasshme edhe për makinat.

Furnizimi me ujë - Zona ekzistuese si tërsi (Lokacioni i gjere), në veçanti dhe zona e ngushtë (lokacioni i ngushtë) ekzistues, nuk posedojnë burime të ujit të rrjedhshëm, nevojat lokale për ujë plotësohen vetëm nga pusët (bunarët) e realizuara me shpime në thellësi rreth 15-20m, që kryesisht shërbejnë për nevoja bujqësore, sanitare, të pijes, etj. Zona si tërësi kohë pas kohe me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike vërshohet nga ujërat e reshjeve atmosferike që vijnë nga përrreth.

Lokacioni nuk posedon asnjë lloj sistemi të ujitjes si nga rrjedhat sipërfaqësore ashtu edhe nga sistemet me gypa nëntokësor, lokacioni ekzistues nuk ka asnjë sistem ujitje dhe në të ardhmen nuk parashihet që në lokacion si tërsi (përfshi lokacionin e ngushtë) të ketë ndonjë projekt për ujitje tokash.

Furnizimi me energji elektrike - Lokacioni i ngushtë si tërësi, si dhe ngastra nr. 00164-27 në veçanti, furnizohen nga rrjeti lokal elektrik (KEDS) në rrjetin fshatit Konjuh dhe qyteti I Lipjanit. Në bashkëngjitje është elaborat për nevojat e energjisë elektrike në lokacion.

Në bazë të inspektimit në terren është vërejtur se rrjeti ajror i furnizimit me energji elektrike, është punuar me kabllo X00 AI 4x70 mm² deri te shtylla e TU, e vendosur në pjesën e

parcelës përball vendit ku do të vendosen kontejnerët. Ky rrjet do të reduktohet deri te hyrja në parcelë dhe i cili rrjet ka një gjatësi pre 410 m. Nga shtylla e TU deri te kuadri kryesor shpërndarës i cili është i vendosur në distancën 120m nga kjo shtyllë, furnizimi me energji elektrike do të punohet me kabllo nëntokesor NAYY-J 4x 95 mm².

Kabloja furnizuese ajrore e cila është punuar me seksion tërthor 70mm², duke u bazuar në fuqinë elektrike të objektit, e cila si fuqi e njëkohshme është 30kË (duke u referuar në fuqitë elektrike të pajisjeve dhe objekteve të cekura me poshtë), nuk i plotëson kushtet për furnizimin e këtij impianti ngase rënia e tensionit në këtë kabllo për gjetësin 410 m, është 3.38%.

Qasja në sistemet e kanalizimit - Lokacioni i zgjeruar, gjithashtu dhe parcela (Lokacioni i ngushte) nuk ka në afërsi as një lloj të rrjeteve publike të kanalizimit. Për nevojat lokale dhe veprimtarinë e planifikuar është e nevojshme dhe e domosdoshme që të aplikohet sistemi me gropë septike akumuluese që do të përfshijnë akumulimin e ujërave të zeza dhe ujërave tjera teknologjike në lokacion. Reshjet atmosferike parashikohet që të përbihen (thithen) nga toka dhe tereni ekzistues zhavorrik. Momentin që institucioni përgjegjës e shtrinë rrejtin e kanalizimit atë herë objekti do të ketë qasje në rrjetin e kanalizimit.

Efektet vizuale (peizazhi) - Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përcaktuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin objekt-mjedis. Në përgjithësi zona ku do të ndërtohet objekti është një zonë bujqësore. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Sipas projektit të planifikuar nga ana e arkitekteve ky objekt nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar pasi që do të ndërtohen mbi strukturën ekzistuese nga zhavorri. Peizazhet e bukura gjenden disa km larg në pjesën veri- perëndimore të këtij objekti.

Mbrojtja nga zjarri - Kontraktuesi do të siguroj dhe mirëmban aparate adekuate për fikje të zjarrit në punishte dhe hapësirat me rrezik nga zjarri do të rrethohen dhe shënohen si dhe do ta furnizoj Objektin me aparate speciale për fikjen e zjarrit, sipas nevojës. Agregatat dhe akumulatorët e tyre dhe pompat e ujit duhet në mënyre adekuate të mbrohen ndaj vandalizmit dhe vjedhjes. Veç nëse udhëzohet ndryshe nga mbikëqyrësi, kontraktuesi me punën e ti nuk do të pengoj (bllokoj) rrugët ose qasjen në objektet tjera, nuk do të rrënon (largon) asnjë rrethojë dhe

nuk do të bllokoj rrjedhjet e ujit dhe kanalizimeve, por nëse vie deri te bllokimi ai duhet menjëherë të largoj bllokimin dhe sanon dëmtimet

7. PËRSHKRIMI I PROCESIN TEKNOLOGJIK

Kompania LTS Kosovo SH.P.K. u Themelua në Prishtinë dhe regjistruar në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me qëllim të rritjes së mirëqenjes dhe krijimin e vendëve të reja të punës, poashtu objektivë që nga fillimi e kishte fillimin e prodhimit të produkteve të cilat importoheshin në tregun vendor, mbulimin e tregut vendor dhe exportin në Bashkimin Evropian.

Bazuar në ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Ligji i vlerësimit të Ndikimit në Mjedis NR. 08/L-181) përshkrimin e karakteristikave kryesore të procesit të prodhimit, është e detyrueshme që të bëhet përshkrimi i procesit teknologjik gjatë hartimit të raportit të VNM-s.

Prandaj në këtë kapitull do të bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik, lendeve hyrëse që përdoren në këtë procese dhe objekteve shoqëruese.

7.2. Pajisjet e Prodhimit të Procesit Teknologjik

Procesi teknologjik për përpunimin e metalit që nxjerrët nga lëllarina e zinkuar për prodhimin e profileve të hapura me trashësi nga 0.4mm–1.6mm dhe produkteve tjera po nga ky metal është një proces i cili është komplet i automatizuar, dhe që nuk shoqërohet me përdorimin e lendeve djegëse dhe përdorimin e ujit në proces teknologjik.

Pra është një proces që si lende të parrë e përdorë vetëm lëllarina e zinkuar dhe nuk përdorët ndonjë material shtesë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur pajisjet që do të përdoren në proces teknologjik janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 6. Lista e pajisjeve të procesit teknologjik.

NR.	LISTA E PAJISJEVE TË PROCESIT TEKNOLOGJIK	SASIA (COPË)
1	Compressor	1
2	De-Coiler	3
3	Eccentric Press	3
4	Material Tunnel	3
5	Roll-forming machine 12 and 14-station	3
6	Turn-out table	2
7	Printer	3
8	Roller holder	3
9	Strapping Machine	3
10	Fork-Lift	1
11	Crane 2 ton mechanic	3
12	Crane 2 ton Electronic	1

13	Punching Unit Corner Bead	3
14	Punching Unit Aluminium Corner	2
15	Set of rollers	15
16	Rotary punching unit	1
17	Metal sheet streightener servo feeder unit	2
18	Automation System	2
19	Tool- Cross Streight conneting piece	3
20	Tool- Quick hanger for 4-pointer	3
21	Tool- CD connection piece 8	2
22	Tool- Streight Ceiling Suspension	2

Sistemi Pinnacle FRAMER X5 (14 matës, fletë metalike 2,0 mm) është një sistem plotësisht automatik prodhimi i profilit C me përmasa të shumta për inkuadrimin e mureve me diametër të lehtë, trarët e dyshemesë C dhe kornizat rezidenciale dhe komerciale me hapësirë të madhe nga 75 mm (3-1/2") deri në 250 mm (10") të pajisur me vegla automatike të 13 madhësive të profilit.

Aplikimet kryesore janë për strukturat rezidenciale të nivelit të mesëm të mesëm të rëndë nga 1 deri në 8 kate, strukturat tregtare të nivelit të mesëm, strukturat e ndërtesave institucionale, strukturat modulare të parafabrikuara, kafazet me hapësirë të madhe dhe strukturat e magazinës.



Figura 14. Pajisja Automation System.

Teknologji e patentuar e formimit të rrotullave, sistem prodhimi me kapacitet të lartë me 15 grupe veglash për të siguruar një sistem të plotë të kornizës prej çeliku.

Sistemi i projektimit dhe prodhimit të patentuar PinnacleTRUSS, korniza inovative B2B dhe struktura totale e magazinës duke përfshirë të gjitha detajet e lidhjes duke përdorur vetëm një profil të madhësisë.



Figura 15. Pajisja De-Coiler.

Aksesorët për të cilat shërbejnë për mbajtjen dhe përforcimin e konstruksionit metalik ne tavane dhe mure.




Figura 16. Pajisja Roller holder.

Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Varseve 4P per CD Anker per CD 4P - Quick hanger for 4-pointer dhe Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Vazhdueseve për CD Vazhdues 80-CD connection peace 8.



Figura 17. 2x Vegël për Prese-Shtance.

Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Distancerave për CD Distancerë-Straight ceiling suspension dhe Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Lidhëseve-kryq për CD Kryqëzor-Cross straight connecting piece.



Figura 18. Vegël për Prese-Shtance për prodhimin e Distancerave për CD Distancerë-Straight.



Figura 19. Tool- Cross Streight conneting piece.

Prodhimin e konstruksionit Metalit të zinkuar që shërbejnë për përforcimin e profileve të dyerve dhe dritareve të plastikës, 12 lloje dhe forma të ndryshme.



Figura 20. Punching Unit Aluminium Corner.

Kapaciteti i projektuar i prodhimit - Kapaciteti i projektuar i prodhimit ne impiant është afërsisht 1000 ton ne vite te përpunimit te llamarinës, ndërsa kapaciteti i realizuar do te jetë si pas dinamikes se punës dhe kërkesave te klientëve.

7.3. Produktet

Pas ndërtimit të objektit në parcelën që ofrohet nga Komuna e Lipjanit, LTS Kosovo SH.P.K. planifikon të investojë dhe instalojë pajisje shtesë të prodhimit të cilat do të na mundësonin prodhimin e 25 produkteve shtesë, si dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese për 200% në krahasim me kapacitetet aktuale. Pra, gjatë vitit të parë të operimit, pas ofrimit të parcelës nga Komuna e Lipjan, LTS Kosova SH.P.K. do të prodhojë 25 produkte të ndryshme.

Produktet kryesore që prodhohen dhe shiten në tregun vendor dhe poashtu export, përfshijnë mbi 14 lloje te profileve metalike nga llamarine e zinkuar për sistemin Rigips apo Knauf të zhvilluara dhe prodhuara sipas specifikave të përcaktuara nga sistemi nderkombetar ISO 9001:2015. Produktet që prodhohen aktualisht nga LTS Kosova SH.P.K., janë prezantuar në

Tabela 7. Emri i produktit.

NR.	EMRI I PRODUKTIT	KAPACITETI I PRODHIMIT M' NË 1 DITË NJË LLOJË PROFILI
1	Profil UD 28/27	5000

2	Profil CD 60/27	7000
3	Profil UW50	5000
4	Profil UW75	5000
5	Profil UW100	5000
6	Profil CW50	5000
7	Profil CW75	5000
8	Profil CW100	5000
9	Kende Suvatimi	3000
10	Kende Alumini per Gips	3000

Pamje e disa produkteve qe do te prodhohen ne impiant.




Figura 21. Pamje e produkteve qe do te prodhohen.



Figura 22. Produktet finale te lloje të ndryshme të profileve.




Figura 23. Produktet finale.

Prodhimin e konstruksionit Metalit të zinkuar për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të ndryshme, 5 lloje të ndryshme të profileve.

7.4. Lënda e pare për te gjitha produktet e lartcekura

Llamarine e zinkuar për prodhimin e Profileve te hapura me trashësi nga 0.4mm – 1.6mm

Kodi I llamarinës se zinkuar: DX51d Kodi tarifar I llamarines se zinkuar Shiritor: 72104900.



Figura 24. Llamarine e zinkuar për prodhimin e Profileve.

7.5. Mbeturinat qe gjenerohen nga ky proces

Mbeturinat qe gjenerohen nga ky proces janë mbeturina te llamarinës, te cilat gjenerohen ne raste te ndonjë defekti a po ngecjeje ne makineritë prodhuese dhe mbeturinat këndore te cilat mbesin si rezultat i prerjes. Këto mbeturina do te trajtohen si pas ligjeve dhe udhëzimeve për mbeturina.

Mbeturinat, grumbullohen ne kontejner te veçan qe do ti vendos kompania dhe me pas merren nga kompanitë qe merren me riciklimin e tyre. Me poshtë janë disa foto te mbeturinave.






Figura 25. Mbeturinat qe dalin nga ky proces teknologji.

8. LOKACIONI I OBJEKTIT




Figura 26. Lokacioni I kompleksit (Informacion nga Harta Zonale Komunale).

Objekti Industrial Prodhimi dhe Përpunimi I profileve metalike i cili planifikohet të ndërtohet në parcelwn kadastrale P-71409036-00164-27 pwrkatwsisht me Koordinatat: Y=7510982.725, X=4713040.392 sistemit Koordinativ të vendit tonë KosovaRef01. Gjendet në një vend strategjik në zonën kadastrale Lipjan përkatësisht në pjeswn veriore të Lipjanit. Zona në fjalë sipas Hartës Zonale Komunale kategorizohet me objkete si depo, afarizw, industrial etj, tipike për llojin e aktivitet që pritet të ndërtohet në këtë lokacion. Në aspektin morfologjik të terrenit ai është I rrafshtë dhe lartësia mbidetare sillet rreth 545 m lartësi mbidetare.

- Përreth zonës është zonë e ndërtuar sipas etazhitetit për zonë komerciale
- Zona është mjaft e zhvilluar dhe ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të komunës së Lipjanit
- Kjo zonë po ashtu edhe tërë zona e lipjanit në aspektin sizmik gjendet në zonën e VIII

9. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Identifikimi i ndikimeve në mjedis të projektit duhet të bëhen gjatë:

- Fazës së ndërtimit të Objektit Industrial;
- Fazës së funksionimit.

Me që kompleksi banesor ende nuk është ndërtuar atëherë ndikimi në mjedis do të analizohet për këtë fazë, ndërsa për fazën e funksionimit do të analizohet në procesin e gjenerimit të mbeturinave dhe disa komponentë kryesor, kurse pjesa tjetër nga zhvillimi i aktivitetit të këtij kompleksi banesor përgjegjësia kalon te investitori. Më poshtë janë paraqitur analiza veç e veç për secilin faktor mjedisor.

9.2. Ndotja e ajrit

Deri më tani mungojnë matjet mbi kualitetin e ajrit, mund të konstatojmë se kjo zonë mund të ndotet kryesisht nga pluhuri, por nuk priten të tejkalohen vlerat kufitare të kualitetit të ajrit sipas OBSH. Gjatë ndërtimit të këtij Objekti Industrial mund të theksojmë se aktivitetet që zhvillohen gjatë ndërtimit nuk shoqërohet me ndotje të theksuar të ajrit. Ndotja e ajrit mund të ndodhë nga punimet gjatë ndërtimit, arsye shtrohet nevoja e marrjes së masave për respektimin e procedurave dhe udhëzimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e tillë të punëve.

Kurse gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk pritet të ketë ndotje të ajrit, pos në disa raste eventuale të furnizimit, deponimit apo prerjeve të materialeve të ndryshme ndërtimore si dru, platike, metal apo të ngurta beton nga pluhuri që do të krijohet, por ato do të jenë në suaza të normales, apo thajse shumë të vogla që nuk do të sjellin ndikim përrreth zonës.

9.3. Ndotja e tokës

Toka si element themelor i natyrës është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vije deri të degradimi i vlerave themelore e karakteristikave të sajë. Sipërfaqja ku do të ndërtohet kompleksi banesor është tokë e llojit Smonicë e pakarbonizuar klasa e III dhe si të tilla nuk paraqet vlera edhe aq të mira bujqësore. Si do që të jetë kjo tokë ka kohë që e ka humbur karakterin e saj prodhues, pasi ka shumë vite që në këtë zonë nuk është punuar apo mbjellur toka pasi që është zonë komerciale afër qytetit. Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë objekt mund të ketë ndikim në tokë. Vlen të ceket që Zona në fjalë po ashtu nuk është zonë e rrezikuar nga Erozioni apo Vërshimet.

9.4. Ndotja e ujit

Ne afërsi të kësaj zone nuk ka ndonjë rrjedhje apo grumbullim të ujërave sipërfaqësore që do të mund të ndikoheshin nga ky projekt. Në anën tjetër niveli i ujërave nëntokësore gjatë kohës me të reshura të larta atmosferike arrinë deri afër sipërfaqes së tokës. Pra ndikim të madhë në ndotjen e ujërave nuk do të ketë. Në këtë zonë në aspektin hidrogeologjik është Akuifer me porozitet ndërgranular me përshkueshmëri mesatare - të ulët (p.sh. argjilë + rërë + baltë/llum) kurse përbërja gjeologjike Argjile, rërë, zhavorr, mergelore, pjesërisht linjtit. Nodjet e ujit kryesisht vijnë si pasojë e ujërave të zeza, por masi që kompleksi banesor ka qasje në kanalizim urban, ndotja e ujit është thuhet zero pasi që gypat e kanalizimit që do të përdoren në kompleksin banesor janë jo ujëlëshues dhe të qëndrueshëm nga plastika për lëvizjen e lirshëm të materieve dhe ujit që vije nga aktiviteti i kompleksit banesor.

Gjatë fazës së hidroteknikës është trajtuar veçanërisht pjesa e kanalizimit dhe paramasave të gypave në të cilën do të bëhet instalimi i kanalizimit dhe ujësjellsit, vetëm që vlenë të ceket që të gjitha llojet e gypave gjatë instalimit do të jenë sipas standardeve evropiane të cilësisë dhe janë të sigurt.

9.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Në bazë të studimeve të bëra në lokacionin e cekur më lartë e që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës kanë treguar se mund të vije deri te ndikimet në biodiversitet (flore dhe fauna) në qoftë se shkelen rregullat të cilat janë të parashikuara me ligje për mbrojtjen e mjedisit. Mirëpo në bazë të incizimit të gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin e caktuar ku do të ndërtohet objekti në Lebushtë të Lipjanit mund të kollaudojmë se nuk kemi konstatuar dëmtim të florës as të vegjetacionit. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritët te këtë ndikime negative në faunë. Veçse kafshët pa strehim mund të rastisen në kështjellat si qenjtë dhe macet, por të cilat duhet të kujdes të veçantë të mos shtypen si pasojë e aktiviteteve ndërtimore.

9.6. Mbeturinat

Si rezultat i punës në ndërtimin e këtij Objekti Industrial për Përpunimin e profileve metalike do të kemi gjenerim të madh të mbeturinave por paraprihen ato të ndërtimit të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Gjithashtu do të ketë edhe gjenerim të mbeturinave komunale, për të cilat do të lidhet kontratë me kompaninë për menaxhim të mbeturinave, po ashtu pas funksionalizimit të kompleksit banesor, do të vendosen kontejner për mbeturina, të cilët do të

menaxhohen nga kompania për menaxhimin e mbeturinave, kurse pagesa do të jetë konformë rregulloreve në fuqi, si për amvisëri po ashtu edhe për biznese.

Kompleksi Banesor do të ketë një vend të veçantë për vendosjen e kontejnerëve të cilët do të jenë të mbuluar sipas standardeve ndërkombëtare, pllatoja do të jetë nga betoni, kontejneri do ta ketë kapakun e veçantë për mbyllje, nuk do të ketë lirim të aromave nga kontejnerët. Në këtë kompleks banesor do të gjenerohen një numër I konsideruar I mbeturinave që janë mbetje të materialeve të përpunuar.

Sasia e mbeturinave e cila pritët të gjendërohet nuk kemi shifwr tw saktw por qw e konsiderueshme do mjaftojë 1 (njw) kontejner 1.1m³, në momentin që komuna bënë implementim në ndarjen e mbeturinave kompleksi është I gatshëm me infrastrukturë për të bërë ndarjen e mbeturinave sipas kërkesave të komunës.

Në momentin kur komuna / kompania fillon me procesin e riciklimit të mbeturinave, kompleksi banesor e ka infrastrukturën e nevojshme. Në raste të grumbullimit të ndonjë mbeturine që mund të ketë ndotje eventuale në tokë, investitori do të grumbulloj ato dhe do të jetë në gadishmëri për dhënien e tyre ndonjë kompanie të licensuar dhe të deponohen në vendin adekuat.

Po ashtu investitori mbanë përgjegjsi për menaxhimin e mbeturinave dhe pagesës së taksave për grumbullimin e mbeturinave komunale dhe atyre mbetjeve te llamarines.

Madhësia, Specifikat teknike, dimensionet si dhe Lokacioni i kontejnerëve është paraqitur grafikisht më poshtë:




Figura 27. Madhësia, Specifikat teknike, dimensionet i kontejnerëve.

Lokacioni I kontejnerëve është përzgjedhur sipas analizës hapësinore dhe sipas kriterëve të cilat I përgjigjen planimetrisë së ndërtesës formës së parcelës dhe faktorëve tjerë të rëndësishëm të zonës. Pozita e tyre është në vendin ku nuk pengon komunikacionin, nuk gjendet afër dritareve, dhe nuk përfshihet zonë e gjelbër apo ndonjë bimë dru afër. Do jenë të mbuluar me kapak dhe si të tillë nuk do të përhapet erë në zonën përreth.



Figura 28. Lokacioni i kontejnerëve.

9.7. Zhurma

Si rezultat i natyrës së punëve në këtë Objekt Industrial nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin për rreth. Që të gjitha mjetet e punës të cilat do të përdoren janë të teknologjisë të cilat nuk do të krijojnë zhurmë, po ashtu edhe muret do të jenë me izolues kundër zhurmës sipas satandarve për nivelin e zhurmës dhe do të zvogëloj ndikimin e zhurmës.




Figura 29. Shpjegimi i Shkallës së Zhurmës në Decibel sipas direktivave Evropiane.

Të gjitha punët që shkaktojnë zhurmë duhet të zhvillohen brenda objektit me izolim. Kompresorët e ajrit dhe të gjitha mjetet tjera që shkaktojnë zhurmë duhet të vendosen brenda objektit të përshtatshëm kundër zhurmës. Gjithashtu Paisjet teknologjike që do të përdoren për punë të jenë me standarde për minimizim kundër zhurmës

Zona është banim përkatësisht shërbim tregtar rural sipas HZK (Hartës Zonale Komunale) ku zhurma gjatë ditës nuk duhet të kalojë 59 dB dhe gjatë natës nuk kalon 49 dB.

10. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Masat e mbrojtjes së mjedisit që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të Objektivit Industrial për përpunimin e profileve metalike, në Konjuh, kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve në mjedis për shkak të rritjes së qarkullimit, përdorimi i mekanizmave të rëndë ndërtimor, gjurmëve të dheut dhe aktivitete tjera gjatë ndërtimit dhe operimit. Gjatë fazës së ndërtimit duhet të ndërmerren këto masa të mbrojtjes së mjedisit.

Fazat e përgjithshme të zhvillimit për projektin në shkallë të gjerë mund të kategorizohen si më poshtë:

- Mobilizimi / Para-ndërtimi: të tilla si përgatitja e vendit, mobilizimi i pajisjeve dhe materialeve në zonën e projektit;
- Ndërtimi dhe Instalimi: përfshirë punimet civile, punimet elektrike dhe instalimin e pajisjeve;
- Operacioni: Funksionimi i impiantit dhe mirëmbajtja rutinë;
- Demontimi: Çmontimi i pajisjeve dhe pajisjeve shoqëruese dhe rehabilitimi i zonës.

Hapësira totale e propozuar e objektivit është 12.5 dhe propozohet të ndërtohet në një fazë të vetme.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarra gjatë fazave të ndërtimit, operacioneve dhe çaktivizimit. Aktivitetet kryesore gjatë këtyre fazave janë përmbledhur në seksionet më poshtë.

- Mobilizimi/Parandërtimi
- Faza e ndërtimit dhe instalimit
- Operimi dhe mirëmbajtja
- Çmontimi dhe mbyllja

10.2. Masat e marra dhe mobilizimi / Para-ndërtimi

Faza e mobilizimit duhet të zhvillohet para se të fillojë puna e ndërtimit dhe instalimit në vendin e projektit. Faza e para-ndërtimit përfshin zhvillimin e fazave të projektimit të detajeve, mobilizimit dhe përgatitjes së zonës së Projektit. Projekti do të zbatohet nga “Kontraktori kryesor”. “Kontraktori kryesor” do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e projektimit, ndërtimit dhe komisionimit të detajuar të impiantit.

Faza e mobilizimit përfshin porositjen e materialeve dhe pajisjeve, nënshkrimin e kontratave me nënkontraktorët dhe punësimin e stafit. Kjo fazë gjithashtu përfshin mobilizimin e punëtorëve, planifikimin dhe transportimin e përbërësve të projektit, pajisjeve dhe materialeve, si dhe përgatitjen e vendit që përfshin pastrimin, nivelimin, nivelimin e vendit dhe krijimin e vendit në zonë për ndërtimin e objekteve. Ky projekt nuk përfshin ndërtimin e godinave për strehimin e punëtorëve.

Pajisjet e rënda dhe pajisjet e tjera do të zhvendosen në vendin e projektit në fillim të aktiviteteve të ndërtimit për aktivitetet e punës civile dhe instalimin e pajisjeve. Të gjitha materialet, pajisjet elektrike dhe strukturore janë planifikuar të arrijnë në zonën e projektit përmes rrugës ekzistuese në "kontejnerë". Përveç pajisjeve, projekti do të kërkonte gjithashtu automjete dhe pajisje të mëdha ndërtimi, të tilla si buldozerë, ekskavatorë, vinça, kamionë, etj.

Gjatë periudhës së përgatitjes së Zonës së Projektit, fuqia punëtore e kërkuar për sigurinë e vendit, punët manuale, punët civile, transportin e mallrave dhe shërbime të tjera të ngjashme ka shumë të ngjarë të merren nga zona lokale.

10.3. Masat e marra gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit

Faza e ndërtimit të projektit do të përfshijë shumë aktivitete dhe faza, të tilla si:

- Ndërtimi / përmirësimi i rrugëve të brendshme të hyrjes;
- Nivelimi i tokës;
- Rrethimi me gardh rreth zonës së Projektit;
- Shtylla të drejtuara për montimin e strukturës;
- Rregullimi dhe instalimet elektrike;
- Instalimi i rezervuarit të ujit për stafin dhe aktivitetet e operatorëve;
- Instalimi i gropës septik;
- Ndërtimi i ndërtesave;
- Testimi dhe komisionimi i pajisjeve dhe projektit në tërësi;
- Pastrimi i zonës së Projektit.

Një pjesë e zonës së Projektit do të përdoret si zonë magazinimi ku do të vendosen pajisjet, pajisjet sanitare (portative) dhe kontejnerët.

Për të siguruar hyrjen në zonën e Projektit nga rruga publike e afërt, do të duhet të përgatitet një rrugë e shkurtër hyrëse (300-500 m) në nivele që do të jenë të pranueshme për transportin e pajisjeve, materialeve dhe njerëzve. Është vlerësuar se rreth 5 eskavator/ ngarkues /

buldozerë do të duhen për pastrimin e tokës dhe 5 deri në 10 kamionë me auto vinça do të kërkojnë për ndërtimin.

10.4. Masat për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Për zbutjen dhe menaxhimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të hartojë dhe zbatojë me përpikëri një Plan të Menaxhimit të Mjedisit dhe masave zbutëse i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit synon respektimin e standardeve mjedisore në përputhje me legjislacionin Kosovar dhe praktikën më të mira ndërkombëtare gjatë kryerjes së aktivitetit ndërtimor të deponisë dhe më pas gjatë operimit të tij, në mënyrë të sigurtë dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e ndotjeve dhe rritjen e përfitimeve në aspektin social.

Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të veprës, si dhe masat përkatëse parandaluese dhe/apo minimizuese deri në nivelet e lejuara ligjore.

10.5. Identifikimi dhe përcaktimi i masave zbutëse dhe menaxhuese

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuar negative në mjedis.

Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore;
- Sistemimin e masës së mbetjeve inerte nga procesi i gërmimit që do të dalë gjatë operacioneve të ndërtimit. Në bashkëpunim me autoritetet vendore të bashkisë do të përcaktohet vendi ku do të depozitohen këto masa dherash dhe shkëmbore, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre do të ripërdoret për mbushjen e digës, ndërtimin e veprave apo për sistemime me qëllim rehabilitimin e zonës së ndikuar nga projekti.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku do të ndërtohet dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagës së zonës së punës dhe mbulimit të makinerive gjatë transportit (gjatë fazës ndërtimore);

- Kontrolli i dherave të gjeneruara, depozitimi i tyre në zona të aprovuara dhe sistemimi i tyre nëpërmjet kompaktësimit;
- Hapja e kanaleve të nevojshëm për drejtimin e ujërave të shiut me qëllim zvogëlimin e erozionit;
- Kontrolli teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit;
- Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara, urbane, të rrezikshme, etj., gjatë fazës ndërtimore dhe funksionale.

10.6. Masat e marruara në Florë

Parashikohet të pastrohet një sipërfaqe e konsiderueshme e vegjetacionit në zonën e projektit. Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të rrugës hyrëse, duhet të kryhet punë rivlerësuese dhe të piketohet saktë gjurma e projektit.

Përdorimi maksimal i rrugëve ekzistuese. Sistemimi i dherave për përdorim në rehabilitimet biologjike pas përfundimit të punimeve.

10.7. Masat e marruara në Faunë

Shqetësim i habitatit natyror që përdoret kryesisht nga zvarranikët, amfibët dhe shpendët.

Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë dhe për të përcaktuar momentet e ndërprerjes së aktivitetit në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit. Mbyllja e rrugëve të përkohshme të kantierit në përfundim të ndërtimit të veprës për të shmangur hyrjen e panevojshme të banorëve në zona të ndjeshme ekologjike.

Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.

Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit të deponisë mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë.

Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra. Vendorsja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).

Largim i përkohshëm i faunës tokësore dhe ujore nga zona e punimeve.

Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars-qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit në zonën e projektit.

10.8. Masat për mbrojtjen tokës Tokë

Marrja e masave për mbrojtjen e tokës janë një numër i konsiderueshëm që duhet të merren, me poshtë do ti përmendëm këto masa:

- Përshtatja dhe përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit, ku përfshihen hapja e rrugëve të aksesit, dhe sistemimi i kantierit të ndërtimit;

Shqetësim i sipërfaqes së tokës (sidomos tokës bujqësore) konsiderohet të jetë i mesatar. Ndotje të mundshme me hidrokarbure dhe lubrifikant si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit. Masat që do të merren;

- Lëvizja dhe parkimi i makinerive brenda zonave të caktuara;
- Përcaktimi i vendeve më të përshtatshme për këtë qëllim;
- Planifikimi paraprak i punës dhe realizim i operacioneve në kohë sa më të shkurtër;
- Kontrolli dhe testimi periodik i gjendjes teknike të makinerive;
- Nëse detyrues duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vend punishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit;
- Në punishte duhet të ketë material (pluhur druri) që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet menjëherë për pastrim.

Sigurisht se në çdo proces të punës ka gjenerim të mbetjeve inerte dhe të ngurta. Këto mbetje duhet të trajtohen:

- Një pjesë e mbetjeve inerte të gjeneruara do të përdoren gjatë fazës ndërtimore të deponisë;
- Pjesa tjetër e mbetjeve të ngurta do të depozitohen në vendet që do të përcaktohen në bashkëpunim me organet;

10.9. Masat e mbrojtjes së ujit

Nëse vjen deri te nevoja për servisimin e makinerive atëherë ajo duhet të bëhet në sipërfaqet shërbyese për servisim. Të gjitha mbeturinat e krijuara gjatë servisimit, pas

përfundimit të punëve duhet të largohen, mbeturinat nuk guxojnë të mbesin në lokacion. Mbeturinat duhet të barten në lokacionet e parapara apo të lejuara në nivel komune apo në deponin regjionale.

Përshtatja dhe përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen hapja e rrugës së aksesit, sistemimi i kantierit të ndërtimit. Nuk pritet ndikime në cilësinë e ujërave. Masa për sistemimin e dherave të rrugës dhe kantierit. Ndërtimi i kanaleve të ujërave të shiut përgjatë trasesë së rrugës.

10.10. Masat e mbrojtjes ajër

- Përshtatja dhe përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen hapja e rrugëve së aksesit, dhe sistemimi i kantierit të ndërtimit.
- Shkarkimet standarde të gazeve, grimcave, pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit.
- Kontroll dhe mirëmbajtje në gjendje të mirë teknike të mjeteve të punës. Përdorim i lëndëve djegëse cilësore për motorët.
- Transporti i materialeve të ndërtimit duhet të bëhet me kamionë me karrocë të mbuluar.
- Në zonat e banuara shpejtësia e automjeteve duhet të kufizohet në 30 km/orë.
- Duhet të evitohet përdorimi i borive nëpër zonat e banuara.

10.11. Masat për Eficiencën e Energjisë

Objekti Industrial për punimin e profileve metalike është ndërtuar nga materialet bashkohore me termoizolim dhe fasada strukturale për ruajtjen e temperaturës, ndriçimi i kompleksit do të jetë me poça LED, kurse aparatura do të jetë e teknologjisë së fundit A+++, kompleksi për ngrohje do ta shfrytëzojë ngrohjen qendrore të kompleksit e cila do të jetë me lëndë djegëse më miqësore me mjedisin, po ashtu kompleksi është e orientuar që të ketë sa më shumë ndriçim dhe rrezatim nga dielli.

BRIGHTNESS BULB	450 lumens	800 lumens	1100 lumens	1600 lumens	2600 lumens	5800 lumens
 LED	6W	9-10W	13W	16-18W	24W special high voltage lamps	45W
 CFL	8-9W	13-14W	18-19W	23W	40W	85W
 Regular Incandescent	40W	60W	75W	100W	150W	300W
 Halogen	29W	43W	53W	72W	150W	300W

Figura 30. Skema në mes dallimeve në poqe.

Masat që do të merren për rritjen e efikasitetit të energjisë në këto hapësira janë:

- Termizolimi është i domosdoshëm;
- Elemente mbrojtës nga dielli;
- Ajrosje natyrale në plotësim të asaj artificiale;
- Ndriçim efikas;
- Pajisje efikase për funksion dhe mirëmbajtje;
- Përdorim i burimeve të rinovueshme të energjisë në shfrytëzim të parkingut dhe ujitjes dhe ndricimit të parkut;
- Kontroll dhe mirëmbajtje e energjisë në kompleks banesor;
- Parkingu dhe ndricimi për të kursyer harxhimet e energjisë elektrike do të pajiset me poqë ndriçues që janë me efikasitet dhe kursejnë energjinë elektrike.



Figura 31. Etiketimi energjetik sipas BE-së.

Rekomandime të Përgjithshme për përmirsimin e Efikasitetit të Energjisë:

- ✓ Fiken aparatet për ngrohjen apo ftohjen gjatë natës dhe kur nuk ka njerëz;
- ✓ Shmang mbulimin e radiatorëve ngrohës me mbulesa, etj;
- ✓ Përcakto kohën optimale të ngrohjes për përgatitjen e ujit të nxehtë;
- ✓ Tw Ulen temperaturën e ngrohjes me 1°C në sezonin e ngrohjes;
- ✓ Vendosen temperaturën e ftohjes me 26°C si minimale në sezonin e ftohjes;
- ✓ Përdorni ndriçimin natyral sa më shumë që të jetë e mundur;
- ✓ Fik dritat në dhomë kur nuk janë të nevojshme;
- ✓ Rregullimi i nyjeve (lidhjeve) të dyerve dhe dritareve me muret;
- ✓ Termoizolimi i taracës dhe çatisë;
- ✓ Instalimi i valvulave termostatike në radiatorët e ngrohjes;
- ✓ Vendosja e grilave dhe tendave gjatë periudhës së nxehtë;
- ✓ Mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve të ngrohjes/ftohjes;
- ✓ Instalimi i kontrollit automatik të energjisë;
- ✓ Vendosja e llambave eficiente;

10.12. Plani Aksional në Raste të Aksidentit

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të zbatimit të projektit. Monitorimi mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme. Elementët e tjerë apo përcaktimi i frekuencave të monitorimit do të përcaktohet në akt miratimin e lejes mjedisore komunale për këtë veprimtari.

Do të bëhet monitorimi i cilësisë së ujit, të ajrit, zhurmës, mbeturinave të gjeneruara dhe gjendja e pajisjeve që përdoren gjatë ndërtimit etj.

Në këtë plan që do të përgatitet me ekspert të fushës përkatëse do të precizohen të gjitha masat për evitimin e aksidenteve qofshin ato nga mjedisore apo natyrore.

- Në rast aksidenti të shkaktuar si pasojë e makinave të cilat mund të shpërdhejnë në zjarrë, ato do të fiken, po ashtu do të njoftohen me kohë Zjarrfikësit komunal dhe mbetjet do të largohen menjëher nga ana e investitorit.

- Në rast se aksidenti do të shkaktohet si pasojë e derdhjes së karburantëve, vajrave, apo betoni të gjeneruar gjatë ndërtimit ato do të largohen me kujdes dhe pjesa e sipërfaqes së dheut do të larohet dhe nuk do të lihet më ata dhe për përdorim.
- Në rast se do të dëmtohet ndonjë prej drunjëve apo gjelbrim apo diçka tjetër afër në zonë investitori do të marrë përgjegjësi dhe to të rikthejë sipërfaqën siq ka qenë duke i mbjellur ato.
- Në rast të aksidentit të shkaktohet si pasojë e punimeve inxhinerike në ndonjë gyp nëntokësor, rrjet elektrik, gjatë armimit, betonimit apo diçka tjetër përgjegjësin do mbajë inxhinieri mbikqyrës po ashtu edhe investitori

Në raste të aksidentit operatori që e menaxhon këtë aktivitet obligohet që menjëherë të njoftojë organin që e ka lëshuar përlqimin mjedisor rrespektivisht Inspektoriatin mjedisor në kuadrin të institucionit që ka lëshuar përlqimin mjedisor.

Për të parandaluar pasojat e mundshme, kompania duhet të zhvillojë plan të menaxhimit të rrezikut nga aksidentet mjedisore. Gjithashtu duhet të përgatitë një plan për parandalimin e zjarrit, por edhe plan për menaxhimin e situatave në raste të zjarrit. Si masë parandaluese, i tërë lokacioni duhet të jetë i rrethuar, mbrojtur nga ndikimet fizike të jashtme. Duhet të vendosen rrethoja adekuate.

Duhet që të ndërmerren të gjitha masat e sigurisë, konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe të mjedisit të punës.

10.13. Masat për Rehabilitimin të Sipërfaqës Gjelbëruese pas Përfundimit të Ndërtimit

Obilgohet investitori të realizojë projektin sipas kushteve ndërtimore të lëshuara nga drejtoria për planifikim urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit të komunës së Lipjanit, sipas projektit të hartuar dhe sipas këtij raporti. Për shfrytëzimi I parcelës duhet të bëhet konform këtyre. Një pjesë e kësaj është edhe rehabilitimi i sipërfaqës pas ndërtimit, në formë që hapësira të merr pamje të bukura ekologjike të pastër.

Sipërfaqja përbëhet nga hapësira jashtë hapësirës ndërtuese ku është planifikuar edhe hapësira gjelbëruese me bari si dhe drunjtë dekorativ, po ashtu në kuadrin e hapësirës gjelbëruese do të mbillen edhe lule sezonale në hapësirat e parapara sipas projektit.

Rehabilitimi i sipërfaqës gjelbëruese pas përfundimit të ndërtimit të Kompleksit banesor përfshinë këto faza:

- Në fazën e parë do të pastrohen hapësirat e parapara për gjelbërim prej mbeturinave dhe tokës jo të mirë.
- Faza e dytë është rrafshimi i sipërfaqës, lëvrimi dhe sjellja e dheut kualitativ të kategorisë së mirë e përzime me tokë humusore.
- Faza e tretë është mbjellja e barit duke u bazuar në procesura standarde agroteknike gjatë periudhës së pranverës së hershme në sipërfaqet e parapara dhe ngjeshja me cilindër të lehtë.
- Faza tjetër është ujitja e hapësirave të mbjella me bari, lule dhe drunjë dekorativ.

Kurse procesi I mirmbajtjes së hapësirës I takon investitorit, pasi që mjedisi jetësor për një zhvillim të qëndrueshëm duhet që të gjithë të kenë edukim ekologjik që të jetohet shëndetshëm dhe pastërt.



Figura 32. Shtresat Pedologjike të sipërfaqes së Tokës.

Tabela 8. Më poshtë edhe tabela e cila tregon Masat per mbrojtjen e mjedisit:

KOMPONENTI MJEDISOR	VEPRIMI QË SHKAKTON NDIKIMI NEGATIV NË MJEDIS	MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
Ujërat dhe Toka	-Ndikimet negative mund të paraqiten nga anashkalimi i menaxhimit të derdhjes së ujërave, rrjedhja e vajrave ose lëndëve djegëse nga automjetet dhe makinerive te tjera me çrast mos menaxhimi i duhur i tyre do te ndikojë edhe në tokën përreth. -Prishja e struktures së shtresës së tokës	-Masat mbrojtëse për zbutjen e ndikimeve per ndotjen e tokës do te kenë ndikim edhe në mbrojtjen e ujerave nentokesore, sepse mbrojtja e tokës nga ndotja do të mbrojë që lëndë të ndryshme toksike që lirohen nga rrjedhje të mos depertojne deri tek ujerat nëntokësorë.

	nga gjurmimi i themeleve dhe mbushja e rrugëve Përdorimi i ujit gjatë fazës së ndërtimit. -Heqja e shtresës së dheut -Hapja e themeleve të objekteve të kompleksit banesor.	-Servisimi i rregullt i automjeteve. -Karburantet dhe vajerat të mos përdoren në vendin e punimit. Nëse detyrimisht kërkohet përdorimi i vajit në punishte atëherë duhet siguruar enë adekuate për mbajtjen e vajit. -Në raste të ndotjes aksidentale të tokës toka e kontaminuar duhet të hiqet dhe të vendoset në konteiner të izoluar ku me pas trajtohet në mënyrë adekuate. -Të minimizohet sa më shumë heqja e shtresës së tokës në vendet pa nevojë për gropim. -Të përdoren sa më shumë të jetë e mundur rrugët hyrese ekzistuese. -Shtresa e hequr e tokës të ruhet dhe të përdoret edhe me tejë për rivitalizimin e tokës pas zbatimit të punëve. -Të merret leja për përdorimin e puseve nga autoriteti rregullator. -Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore përgjatë gjithë zonës së punimit të akumulohen në kanale drenazhuese për të kufizuar përqendrimin e prurjeve në mënyrë që të kontrollohet eurozioni i tokës. -Gjatë fazës së ndërtimit të përdoret një sasi e arsyeshme e ujit për spërkatje të rrugëve për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit nga lëvizja e makinerive. -Gjatë hapjes së themeleve të objekteve të kompleksit banesor të kihet parasyshë pasi që afër në pjesën perendimore të parcelës gjendet zona e mbrojtur e ujërave sanitare prandaj të gjitha aktivitetet duhet të bëhen
--	--	--

		konform UA Nr.15/2017, që të mos u shkaktoj dëm ujërave nëntokësore.
Ajri	-Ndotja e ajrit ndikohet nga lirim i gazeve nga djegia e karburanteve të makinave të ndërtimit, automjeteve. -Krijimi i pluhurit gjatë fazës së ndërtimit nga lëvizja e automjeteve. Krijimi i pluhurit gjatë punimit në ndërtimin e objekteve të kompleksit Banesorë.	-Të i kushtohet rëndësi edhe pajisjeve makinerike që përdoren për transport që të mos të lirojnë gazra e me këtë të ndotet ajri mirëpo ato të mirëmbahen në mënyrë të rregullt. -Përdorimi i lëndëve djegëse cilësore për motorët Të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra. -Mirëmbaje dhe ujite në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqen e tokës ku operon në mënyrë që të mos krijohet pluhuri; Të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra. -Kufizimi i shpejtësisë në zonat e pashtuara, dhe në zonën e punimit dhe marrja e masave të nevojshme për zbutjen e ndikimeve në ajër nga emetimet e pluhurit me anë të spërkatjes me ujë të tokës ose masa të tjera. -Mjetet që shpërndajnë material të mbulohen. -Gjatë periudhave me erëra të forta tëshëmangen aktivitete që prodhojnë shumë pluhur. Të sigurohen maska të pluhurit për punëtorë në qoftëse në zonën e punimit krijohet pluhur.
Flora dhe Fauna	-Ndikim i mundshëm në florën dhe faunën lokale.	-Pasi në vendin e punimeve dhe në zonë në përgjithësi, nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ky ndikim është minimal, dhe

		pothuajse jo relevant. -Mund të ndodh që gjatë transportit dhe ndërtimit të kompleksit banesor të ketë aksidente si shtypja e faunës në rrethin. Duhet të kërkohet kujdes i shtuar i stafit të realizimit të punës gjatë ngasjes që të mos ketë përplasje të kafshëve (sidomos qenët endacak. -Minimizimi i pastrimit të bimësisë vetëm në zonat e kërkuara. Përdorimi maksimal i rrugëve efikase. -Përdorimi i dherave për rehabilitimin biologjik pas përfundimit të punimeve.
Peizazhi	-Peizazhi lokal do të ndryshohet nga ndërtimi i kompleksit Banesor , levizja e përkoheshme e makinave të ndërtimit. - Nga heqja e dheut, dhe punimi me materialet punuese do të mbizotrojnë në zonë gjatë punimeve.	-Ndikimi vizual i krijuar gjatë fazës së ndërtimit është i përkohshëm dhe pjeserishtë i dukëshëm. -Zona do të rrethohet me një gardh të përshtatshëm për sigurinë e punishtës dhe banorëve. -Do të ketë ndikimi pozitiv në peizazh duke krijuar sipërfaqe të bukura dhe gjelbëruese. -Pas përfundimit të ndërtimit të kompleksit banesor të rregullohet sipërfaqja gjelbëruese e paraparë sipas projektit kryesor dhe kushteve ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore	-Nuk ka objekte të trashëgimisë kulturore në zonën e ndërtimit	
Mbeturinat	-Procesimi i mbeturinave gjatë fazave të operimit. -Gjenerimi i mbeturinave nga banorët.	-Materialet e forta do të dërgohen në vend të caktuara nga Komuna e Lipjanit. -Mbeturinat që krijohen nga

	-Ndikimi i mbeturinave në aspektin visual. -Grumbullimi i panevojshëm i nje sasive të madhe të mbeturinave për shkak të mundësisë së trajtimit me anë të riciklimit dhe ripërdorimit. -Ndikimi në cilësinë e tokës dhe ujërave nëntokësore nga menaxhimi joadekuat i mbeturinave.	veprimtaria ndërtimore, të sistemohen të ndahen dhe të veçohen sipas llojit të tyre, dhe të vendosen në vendet e caktuara për qëndrimin e tyre të përkohshëm. -Do të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbeturinat e ekspozuara ndaj erës. -Për transportin e materialeve dhe të mbeturinave të përdoren makina të mbuluara dhe që nuk rrjedhin. -Identifikimi dhe klasifikimi i mbetjeve sipas listës së mbetjeve. -Kontraktimi i një kompanie të autorizuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të gjeneruar në zonën e operimit, në mënyrë adekuate. -Mbeturinat komunale të prodhuara nga punëtorët do të menaxhohen nga Kompania e pastrimit. Mbeturinat komunale të prodhuara nga punëtorët do të menaxhohen nga Kompania e pastrimit. -Të sigurohet një zonë e veçantë për ruajtjen e përkohshme të materialeve të rrezikshme, të cilat mbledhen veçmas. -Kontraktuesi duhet të sigurojë kontejner të mbledhjes së mbeturinave për të parandaluar hudhjen e mbeturinave në zonën e ndërtimit dhe përreth. -Magazinimi i duhur i paneleve të thyera ose të demtuara dhe identifikimi i tyre për depozitim. Menaxhimi i duhur dhe asgjësimi i mbetjeve të lengshme ujërave të zeza nga punëtorët. -Pastrimi i mirë i përgjithshëm i zonës. -Krijimi i një orari të rregullt për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e mbetjeve nga ana e kontraktorit.
Zhurma		

	-Lëvizja e automjeteve të ndertimit. Ndertimi i rrugës hyrese. - Mjetet e punes të cilat do të punohet në kompleks.	-Niveli i zhurmës është nën kufijtë e standardit dhe gjatë punës nuk duhet të kalon 40 Db sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore që tani janë në fuqi; -Të kontrollohen vazhdimisht pajisjet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet te shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorëve te mjeteve motorike, duke mirëmbajtë dhe duhet kushtuar rendësi e veçantë të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.
Zjarri	-Në rastë të ndonjë fatkeqësie natyrore apo të shkaktuar nga rrufeja, pakujdesia etj. - Në rast të aksidentit të zjarrit nga makineritë e punës -Rreziku me i madhë për ndonjë aksident zjarri vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrik.	-Vëndosja e rrjetit hidrant për shuarjen e zjarrit. -Pajisje për zjarrfikje të vendosen tek objektet e kompleksit banesor, në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë; -Banorët do të informohen për përdorimin e tyre. -Investitori do të siguroj dhe mirëmban aparate adekuate për fikje të zjarrit në hapësirat me rrezik nga zjarri do të rrethohen dhe shënohen si dhe do të furnizoj aparate speciale për fikje të zjarrit, sipas nevojës Do të merren masta adekuate nga investitori për ruajtjen e popullatës lokale në rast te ndonjë fatkeqesi të shkaktuar nga zjarri; -Agregatet dhe akumulatorët e tyre dhe pompat e ujit duhet në mënyre adekuate të mbrohen ndaj vandalizmit dhe vjedhjes.

11. MENAXHIMI DHE MONITORIMI I MJEDISIT

11.1. Kontraktori

Kontraktori do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit shoqëror dhe mjedisor të monitorimit dhe menaxhimit gjatë gjithë periudhës së ndërtimit. Detyrat kryesore të kontraktorit do të përfshijnë:

- Zbatimi i menaxhimit të mjedisit, sigurisë dhe shëndetësisë gjatë punimeve të ndërtimit;
- Rregullimi i burimeve njerëzore dhe financiare, kujdesi shëndetësor dhe siguria;
- Raportet dhe komunikimi për performancën mjedisore gjatë punimeve të ndërtimit;
- Përgjegjësia për zbatimin e masave të përfshira në planin e monitorimit, si dhe menaxhimin social dhe mjedisor;
- Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, Kontraktuesi do të themelojë një Njësi Mjedisi, e përbërë nga të paktën një Zyrtar Mjedisi, i cili do të jetë përgjegjës për aspektet sociale dhe mjedisore.

Përgjegjësitë e zyrtarit mjedisor - plani i monitorimit dhe menaxhimit të mjedisit:

- Harton planin mjedisor dhe përcakton procedurat e punës të procedurave ekzistuese për përfshirjen e parametrave mjedisorë të nevojshme për zbatimin / modifikimin e tij;
- Organizon dhe zhvillon trajnime paraprake dhe periodike për çështjet mjedisore për të gjithë personelin;
- Ndihmon drejtuesit e Kontraktorëve për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me çështjet mjedisore;
- Mbikëqyrja dhe zbatimi ditor i VNM;
- Kontaktet me autoritetet lokale në lidhje me lëshimin e lejeve të nevojshme mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë;
- Ndihmon autoritetet në inspektimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë;
- Përgatit raporte vjetore për procesin e implementimit për inxhinierin.

11.2. Inxhinieri i Mjedisit

Roli i inxhinierit do të jetë të mbikëqyrë me efikasitet zbatimin gjatë fazës së ndërtimit dhe masat zbutëse, të propozuara nga Kontraktori.

Inxhinieri do të kryejë përgjegjësitë e tij mjedisore përmes:

- Ndihmën që ai do të sigurojë për kontraktorin në përgatitjen e planit të menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit në përputhje me fushën e tij të punës;

- Organizimi i seancave udhëzuese për Zyrtarin e Mjedisit të Kontraktorit;
- Të sigurohet që plani i lartpërmendur të përgatitet para fillimit të punëve dhe që përgjegjësitë të përcaktohen qartë;
- Të inspektojë çdo ditë zbatimin e masave mjedisore në të gjithë zonën e ndërtimit për nevojat e kontraktorit;
- Të sigurohen që të gjitha lejet mjedisore, të kërkuara nga legjislacioni kombëtar, janë marrë dhe janë të vlefshme;
- Të ndihmojë organizimin e auditiveve të jashtme mjedisore.

11.3. Qeveria e Kosovës / Ministria përkatëse / Klienti

Qeveria / ministria përkatëse është organi kryesor vendimmarrës për procesin e zhvillimit dhe zbatimit të projektit. Ai miraton projektin dhe masat e propozuara të zbutjes dhe kompensimit pas konsultimeve me autoritetet përgjegjëse të mjedisit.

Ai gjithashtu sigurohet që dispozitat e zbatimit të VNM (lista e masave që duhet të zbatohen, programi i monitorimit, etj.), janë përfshirë në paketën kontraktuale të Inxhinierit dhe Kontraktorit. Së fundmi, Qeveria / klienti luan rolin kryesor në zbatimin e masave të kompensimit në lidhje me shpronësimin, ri-strehimin dhe kompensimin financiar për humbjen e pronës private (nëse do të ketë tokë private). Qeveria / Klienti do të marrë përsipër përgjegjësinë nga kontraktori për zbatimin e masave mjedisore në fund të fazës së ndërtimit.

11.4. Autoritetet përkatëse të mjedisit

Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare të Kosovës, përgjegjëse për inspektimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit, do të kenë një rol të dyfishtë:

- Të garantojë që veprimtaritë e ndërtimit janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret kombëtare, si dhe lejet dhe autorizimet përkatëse (p.sh. lejet për ujë, gjërmim, dhe nxjerrjen e materialeve, emetimet në ajër, lejen për hedhjen e mbeturinave, (përfshirë transportin dhe magazinimi i mbetjeve të rrezikshme, etj.);
- Të kryejë një inspektim të rregullt për t'u siguruar që aktivitetet e ndërtimit po kryhen pas autorizimeve të lëshuara.

11.5. Monitorimi i mjedisit

Programi i monitorimit do të zvogëlojë kërcënimin për mjedisin, i cili mund të vie si rezultat i ndërtimit dhe përdorimit të rrugës. Roli i monitorimit të mjedisit përcaktohet si më poshtë:

- Monitorimi i performancës mjedisore të procesit të ndërtimit;
- Kontrollimi i efikasitetit të masave të propozuara zbutëse;
- Kontrolli i niveleve të detyrave të menaxhimit mjedisor të marra nga Kontraktori;
- Identifikimi i përmirësimeve të VNM dhe aktivitetet korigjuese.

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për monitorimin e procesit gjatë periudhës së ndërtimit. Gjatë përdorimit të deponisë, parametrat mjedisorë do të monitorohen nga autoritetet lokale, si dhe ekspertë të pavarur.

Plani i monitorimit të deponisë do të përfshijë parametrat e mëposhtëm:

- Nivelet e zhurmës në banesa dhe zona të tjera të ndjeshme së bashku me deponinë e ardhshme;
- Nivelet e ndotjes së ajrit në një zonë rezidenciale në afërsi të deponisë;
- Niveli i gjelbërimit të mbjellë dhe niveli i riprodhimit të bimësisë së pastër;
- Cilësia e ujit në linjat ujore lokale;
- Sëmundjet, të shkaktuara nga emetimi i pluhurit siç raportohen nga qendrat e kujdesit shëndetësor;
- Numri i aksidenteve të trafikut të raportuara;
- Mbikëqyrja e sistemit të kullimit pas ndërtimit;

Monitorimi mbulon çështje mjedisore si:

- Ujërat sipërfaqësorë;
- Ujërat nëntokësorë;
- Cilësia e ajrit (pluhuri);
- Cilësia e ajrit (NO_x);
- Zhurma;
- Fauna, flora dhe habitatet natyrore;

Metodologjia, parametrat, frekuencat dhe procesi i raportimit janë në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi në Republikën e Kosovës.

12. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e “Impianti për deponimin e materialeve zjarrduruese të përdorura” si dhe në bazë të vlerësimit të projektit të propozuar, për lokacionin e analizuar sipas autorit të raportit nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vije deri te ndotja duhet të ndermiren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri të rrezikimi i mjedisit jetësor.

Nga sa u tha më sipër nxjerrim si përfundim se:

- Objekti duhet ndërtuar në një zonë të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti, i cili do të ndikojë pozitivisht edhe në zhvillimin ekonomik të zonës;
- Teknologjia që do të zbatohet është e përshtatshme dhe funksionale;
- Në veçanti, nga analiza e kryer në tërësi e këtij aktiviteti, nuk konstatohen ndikime të veçanta mjedisore si në florë, faunë, tokë, ujë dhe ajër.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshëm të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave shtesë të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në objektin për rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta. Nga vlerësimi në përgjithësi i këtij aktiviteti konstatohet se:

- Nuk vërehen ndikime negative të aktivitetit;
- Është lehtësisht i zbatueshëm;
- Teknologjia e zbatuar është bashkëkohore;
- Makineritë dhe pajisjet janë të thjeshta,
- Zona ku zhvillohet ky aktivitet është zone me bazë zhavorri me një shtresë humusore jo më të trashë se 5-10cm si rezultat i bartjes së limit ndër vite.

Gjate funksionimit të këtij aktiviteti janë marrë të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedisin përreth. Për këtë qëllim ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor pasi:

- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta;
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave jashtë normave të lejuara;
- Zhurmat në mjediset e punës pritet të jenë brenda normës sanitare të lejuar dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth;
- Ka vlera normale të temperaturës dhe lagështisë në mjediset e punës;

- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.
- Të bëhet rrethimi i vendpunishtes gjatë ndërtimit, dhe të vendosen tabela paralajmërues për rreziqet për punonjësit dhe kalimtarët.
- Të vendoset zhavor në pjesët e ngarkimit dhe shkarkimi të kamionëve
- Të bëhet spërkatja e sipërfaqeve të materialit dhe inerteve me pluhur si dhe rrugëve komunikuese, që mos të ketë ngritje të pluhurit në ajër.
- Të kryhet larja apo pastrimi i gomave të automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- Gjatë gjithë kohës së ndërtimit të kompleksit banesor në vende punishte të grumbullohen mbeturinat të ndahen sipas llojit (letra, plastik, stiropor, blloka, tulla, etj.) të vendosen në kontejner i cili duhet të jetë në vendpunishte dhe t'i dorëzohen mbeturinat kompanive të licencuara për menaxhim të tyre.
- Transporti i dherave, mbetjeve të ngurta mbeturinave të ndryshme të kryhet me mjete transporti të mbuluara që gjatë transportit mos të ketë ndotje në mjedis.
- Gjatë ditës nga ora 07:00 deri me 19:00 niveli i zhurmës të mos kaloj normat lejuara ashtu siç parashihet me ligje, ndërsa pas orës 19:00 nuk do të ketë punime.
- Të vendosen shenja sensibilizues për punonjësit për një mjedis të pastër.
- Të zbatohen masat për eficient të energjisë, muret e jashtme të izolojnë me stiropor 8 cm N3, dritaret të jenë termopan, llampa kursyese të energjisë, llampa solare dhe automatike.
- Fasada të jetë cilësore për të krijuar një pamje estetike integruar me elemente të zonës.
- Të respektohet përqindja e krijimit të hapësirës gjelbëruese sipas kushteve ndërtimore dhe situacionit të projektit të ndërtimit.
- Të mbjellën bimë, fidane shumëvjeçare dekorative autoktone të qëndrueshme. Oazat për gjelbërim të mbillet me bari, (bari Slloven), shkurre, fidane shumëvjeçare, Bli gjethegjere (Tilia), dru Rrapi (Platanus orientalis), pisha të varietetit Nordman, Smarak, etj.
- Pas ndërtimit të kompleksit banesor të rregullohet vendi i vendosjes së kontejnerëve me rrethoj dhe mbulojë nga llamarinat.
- Kompleksi banesor të kyçet në rrjet të ujësjellësit me pëlqim nga KRU Prishtina, ndërsa për ujëra të zeza rregullohet kyqja në kanalizim.

- Gjatë aktivitetit të kompleksit banesor për grumbullimin e mbeturinave do të nënshkruhet kontratë me kompaninë rajonale KRM Pastrimi.
- Investitori do të vendosen tre kontejner të madhësisë 1.1 m³ për grumbullim të mbeturinave.
- Përreth perimetrit të kompleksit banesor duhet të ndërtohen kanale drenazhuese për mbledhjen e ujërave atmosferike.
- Përreth zonës së mbrojtur të ujërave nuk duhet të kryhen aktivitete ndërtimore.
- Pas marrjes së lejës së rrënimit të kabinës së ketë kujdes gjat rrënimit të saj ai material duhet të grumbullohet dhe të deponohet në vend legal adekuat e mos të hidhet në natyrë.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në vendimin e LMK-së që do të miratohet nga Komuna.
- Investitori të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të LMK-së.
- Të zbatohen masat për mbrojtjen e ujërave nëntokësore sipas raportit.
- Investitori të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Investitori të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objektet e kompleksit për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikësit.

Përfundim:

Ndikimi në Mjedis gjatë ndërtimit të Objektivit Industrial për Prodhimin dhe Përpunimin e profileve metalike në Rrugën “Hasan Prishtina” Zona Kadastrale Konjuh në Komunën e Lipjanit përkatësisht në parcelën kadastrale P-71409036-00164-27 me sipërfaqe të përgjithshme 2500.00 m² do të jetë në nivelin e vlerave të standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme. Ndikimet në ajër, tokë, ujë, zhurmë si dhe ndikimet tjera mund të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe nëse evidentohen probleme mjedisore do të raportohet në Komunën e Lipjanit. Pas punimit të këtij raporti të VNM-së, mund të konkludohet se Objekti Industrial nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në ajër, tokë, ujë dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport të VNM-së ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm, edhe të synohet eliminimi i tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme organit kompetent të ministrisë për dhënien e mendimit pozitiv për Përvëqim Mjedisor për objektin ndërtimor në fjalë.

13. Referencat

1. Illyrian Consulting Engineers sh.p.k. Tiranë, 2021;
2. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007, Prishtinë;
3. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007, Prishtinë;
4. MMPHI (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I), Prishtinë;
5. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009, Prishtinë;
6. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016;
7. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosovës 2015;
8. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014;
9. HZK Lipjan;
10. Qavolli. R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës. Prishtinë;
11. Te dhënat nga investitori.